

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe i Drejtimit të Brendshëm

Devoll Hydropower Sh.A. (DHP)



2023



PËRMBAJTJA

5 Raporti i Ecurisë së Veprimitarisë

- 5 Përshkrim i shoqërisë
- 7 Raport nga Bordi i Drejtorëve
- 7 Vizioni dhe vlerat
- 8 Qëndrueshmëria
- 9 Strategjia
- 10 Objektivat strategjike
- 10 Ecuria financiare
- 11 Vijimësia
- 12 Kërkimi dhe zhvillimi
- 12 Administrimi i rrezikut
- 17 Qëndrueshmëria
- 19 Si i promovojmë praktikat e përgjegjshme të biznesit
- 25 Si e mbështesim tranzicionin e gjelbër

30 Raporti i Drejtimit të Brendshëm

- 31 Bordi i Drejtorëve
- 31 Drejtimi i brendshëm
- 33 Administrimi i Rrezikut dhe Kontrolli i Brendshëm
- 37 Treguesit kryesorë
- 38 Matësit Alternativë të Ecurisë

VIZIONI I STATKRAFT:

Rinovojmë energjinë që fuqizon botën

Ne kemi besuar gjithmonë në një energji më të mirë. Energji që rinovon veten dhe botën. Energji që krijon një të ardhme pozitive dhe të qëndrueshme për njerëzit, komunitetet, industrinë dhe mjedisin tonë. Ne jemi pionierë të energjisë së pastër dhe të rinovueshme prej më se një shekulli, dhe kjo është energjia që botës tonë i duhet tani më shumë se asnjëherë më parë. Nga ekspertiza jonë kemi parë vlerën që sjell dhe të mirën që mund të arrijë. Tani është detyra jonë që kjo energji të fuqizojë botën.





Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë

Përshkrim i shoqërisë

Devoll Hydropower Sh.A. (DHP) është një shoqëri e regjistruar në Shqipëri, në pronësi të Statkraft Markets B.V., një shoqëri e regjistruar në Hollandë, pjesë e Grupit Norvegjez Statkraft. Në përputhje me një Marrëveshje Koncesioni, DHP është përgjegjëse për ndërtimin dhe operimin e Projektit Hidroenergjetik të Devollit përgjatë lumit Devoll, në Shqipërinë Juglindore. Marrëveshja e Koncesionit bazohet në një model BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe u nënshkrua me Qeverinë e Shqipërisë në 19.12.2008, miratuar nga Parlamenti Shqiptar përmes Ligjit Nr. 10083, datë 23.02.2009, i ndryshuar.

DHP operon dy hidrocentrale të mëdha (Banja dhe Moglica) me një kapacitet total të instaluar prej afërsisht 269 MW dhe një prodhim mesatar prej afërsisht 700 GWh / vit të energjisë së rinovueshme, në harmoni me mjedisin. DHP është gjithashtu tregtues i energjisë në tregun lokal dhe rajonal të energjisë.

HEC-i i Banjës filloi veprimtarinë tregtare në 2016, ndërsa HEC-i Moglicës filloi veprimtarinë tregtare në 2020. DHP po vlerëson se si të zhvillojë më tej potencialin hidroenergjetik të lumit Devoll brenda të drejtave të Marrëveshjes së Koncesionit pas pajtueshmërisë me kërkesën minimale teknike të koncesionit.

DHP ka zyrat e saj në Tiranë, me zyra në terren në të dy hidrocentralet, Banjë dhe Moglicë. Projekti Hidroenergjetik i Devollit është investimi më i madh privat në energjinë e rinovueshme në Shqipëri në 30 vitet e fundit.

Raporti Vjetor 2023


Duke filluar nga viti 2020, DHP publikon pasqyrat financiare vjetore dhe RAPORTIN E ECURISË SË VEPRIMTARISË DHE DREJTIMIT TË BRENDSHËM në faqen e internetit të DHP-së. Çdo vit, DHP dorëzon këto dokumente në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

DHP thekson komunikimin transparent me të gjithë palët e interesuara. Informacioni që shoqëria i ofron aksionarit të saj dhe palëve të tjera të interesuara duhet të sigurojë detaje të mjaftueshme për të lejuar një vlerësim të vlerave themelore të shoqërisë dhe ekspozimit ndaj rrezikut.

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe i Drejtimit të Brendshëm është përgatitur gjithashtu në përputhje me nenet nr. 17 dhe nr. 19 të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare nr. 25/2018, datë 10.05.2018. Raporti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të shoqërisë.

Rigela Gegprifti

Drejtoreshë e Përgjithshme

An aerial photograph of a large dam and reservoir. The dam is a long, grey concrete structure with a spillway on the left. The reservoir is a large body of blue water that fills a valley. The surrounding landscape is mountainous and green. A semi-transparent blue circle is overlaid on the upper part of the image, containing white text.

Ambicia e DHP-së
është të ketë ekselencë
në operacione dhe
të zhvillojë më tej
potencialin e Kaskadës
së Devollit

Raport i Bordit të Drejtorëve

Gjatë vitit 2023, çmimet e energjisë në Evropë shënuan një rënie krahasuar me çmimet ekstreme të një viti më parë. Kjo kryesisht për shkak të uljes së kërkesës, furnizime shtesë të gazit nga Norvegjia dhe importet, si edhe një dimër relativisht i butë. Megjithatë, për pjesën më të madhe të vitit çmimet ishin në nivele më të larta krahasuar me periudhën përpara pushtimit të Ukrainës nga Rusia.

DHP ka një angazhim të fortë ndaj qëndrueshmërisë dhe vazhdimisht punon për të përmirësuar performancën e qëndrueshmërisë për të aderuar me ligjet e reja dhe pritshmërinë e rritur të grupeve të interesit. Kujdesi për njerëzit është në bërthamën e kulturës së Shoqërisë. Çdokush duhet të kthehet në banesë i sigurt. Gjatë vitit 2023 nuk është regjistruar asnjë dëmtim serioz nga aktivitetet tona në Shqipëri. Përforcimi i kulturës së sigurisë dhe performancën e saj – brenda DHP si edhe tek kontraktorët – vazhdon të mbetet prioritet i lartë i Shoqërisë.

Hidrologjia në ujëmbledhësin e Lumit Devoll ka qenë shumë sfiduese gjatë vitit 2023, me reduktim të konsiderueshëm të prurjeve ujore në rezervuarët tanë, krahasuar me historikun e prurjeve. Kjo ka rezultuar në ulje të konsiderueshme të sasisë së prodhimit të energjisë elektrike. Megjithatë, menaxhimi aktiv i energjisë dhe rritja e çmimit të energjisë elektrike ka rezultuar në një ecuri të mirë financiare të asetëve tona.

VIZIONI

Rinovojmë energjinë që fuqizon botën

Ne kemi besuar gjithmonë në një energji më të mirë. Energji që rinovon veten dhe botën. Energji që krijon një të ardhme të qëndrueshme për njerëzit, komunitetet, industrinë dhe mjedisin tonë.

Ne jemi pionierë të energjisë së pastër dhe të rinovueshme prej më se një shekulli, dhe kjo është energjia që botës tonë i duhet tani më shumë se asnjëherë më parë.

Nga ekspertiza jonë kemi parë vlerën që sjell dhe të mirën që mund të arrijë. Tani është detyra jonë që kjo energji të fuqizojë botën.

VLERAT

DHP ka integruar vlerat e Statkraft-it. Vlerat tona udhëheqin si veprimet e Statkraft ashtu edhe të punonjësve tanë. Këto vlera i aplikohen të gjithë punonjësve dhe atyre që përfaqësojnë Statkraft-in.

Veprojmë me përgjegjshmëri me përkujdesje dhe përgjegjësi. Përkujdesemi dhe jemi gjithmonë të vetëdijshëm, se si puna jonë ndikon tek kolegët tanë, klientët, shoqëria dhe mjedisi.

Rritemi bashkë duke qenë të gjithë një ekip, mësojmë si nga suksesi edhe dështimet. Jemi një Statkraft, kudo. Sjellim ekspertizën tonë, njohim vlerën e diversitetit dhe mësojmë nga çdo situatë.

Ndikojmë pozitivisht duke gjetur mënyra më të mira dhe duke krijuar progres dhe vlerë. I pranojmë sfidat, përqendrohemi në gjërat e rëndësishme dhe ofrojmë zgjidhje që sjellin ndryshime pozitive.

QËNDRUESHMËRIA

Fusha e qëndrueshmërisë po evoluon më shpejt se kurrë më parë, dhe ambiciet ndërkombëtare janë në rritje. Nevoja për të garantuar një tranzicion si të gjelbër ashtu edhe të drejtë ka qenë edhe më e dukshme gjatë vitit 2023 dhe tabloja ligjore po ndryshon në mënyrë rrënjësore në përgjigje të saj.

Rëndësi të veçantë ka Direktiva e BE-së për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (DRQK) dhe përdorimi për herë të parë i Standardeve Evropiane për Raportimin e Qëndrueshmërisë (SERQ), të cilat vendosin standardin nga viti fiskal 2024 jo vetëm për raportimin e ri, por edhe për mënyrat e zbatimit, integritimit dhe përmirësimit të praktikave dhe proceseve të brendshme.

Ambiciet dhe objektivat

Statkraft përditësoi strategjinë e qëndrueshmërisë në vitin 2023. Kjo u realizua në përputhje me përditësimin e strategjisë vjetore, duke lidhur më afër aspektet e biznesit dhe të qëndrueshmërisë. Strategjia e Qëndrueshmërisë fokusohet në katër fusha kyç: aksioni lidhur me klimën, qarkullueshmëria, biodiversiteti dhe të drejtat e njeriut. Këto fusha kyç janë përzgjedhur për të reflektuar si trendet e jashtme, ashtu edhe çështjet materiale të operimeve të Statkraft. Aksioni i lidhur me klimën është qendror në vizionin tërësor të shoqërisë. Statkraft përpiqet të kontribuojë në këtë drejtim me anë të ofrimit të energjisë së rinovueshme dhe duke menaxhuar me përgjegjshmëri ndikimin e saj ndaj klimës dhe natyrës, dhe duke adoptuar një mendësi qarkulluese. Gjithashtu, në mënyrë që bota të shkojë drejt një të ardhme më të gjelbër, mënyra për ta arritur këtë nevojitet të jetë e drejtë, dhe shoqëria ka një përgjegjësi të rëndësishme për të respektuar të drejtat e njeriut në ndryshimet që priten të vijnë në të ardhmen.

Njëkohësisht, sjellja jonë e biznesit duhet të jetë e qëndrueshme dhe e përgjegjshme – dhe do të kontribuojmë në mënyrë aktive për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Për të ardhmen e qëndrueshme kontribuojmë me anë të:

- Biznesin tonë kryesor – sjellim energji të rinovueshme
- Praktikën tonë të biznesit – duke vepruar në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme

Për ta maksimizuar kontributin tonë, përpiqemi të kuptojmë ndikimin tonë, të zbatojmë masa ku është e nevojshme dhe ndjekjen e tyre në vazhdimësi e integrojmë si pjesë të punës tonë të përditshme.

Ndikimi ynë mund të jetë pozitiv ose negativ. Të jemi të hapur për të dy dimensionet dhe të përpiqemi vazhdimisht të përmirësohemi se si operojmë është në qendër të qasjes tonë ndaj qëndrueshmërisë.

Angazhimi i përgjithshëm i Statkraft për shëndetin dhe sigurinë është të kemi një ambient pune pa incidente apo dëmtime. Ky angazhim ndiqet nga afër me anë të një programi përmirësimi për mbarë grupin: "Fuqizuar nga kujdesi"

Statkraft është angazhuar të ketë standarde të larta të sjelljes së biznesit. Është në zbatim një program përputhshmërie që

mbulon fushat e korrupsionit, mashtrimit, pastrimit të parave, sanksioneve dhe kontrollin e eksporteve, si edhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjin e konkurrencës. Shoqëria ka nivel të lartë kundrejt parandalimit të shkeljeve të përputhshmërisë, me burime shtesë të vëna në dispozicion në kuadër të aktiviteteve të rritjes.

Menaxhimi i qëndrueshmërisë

Në punën e saj në lidhje me qëndrueshmërinë, DHP zbaton ligjet dhe rregulloret shqiptare, si edhe udhëhiqet nga udhëzime dhe kuadro rregullatore ndërkombëtare sipas rastit, përfshirë Udhëzimet për Sipërmarrjet Ndërkombëtare të OBZHE dhe Parimet Udhëheqëse për Biznesin dhe të Drejtat e njeriut të OKB-së. Statkraft është anëtare e Marrëveshjes Globale të Kombeve të Bashkuara (UN Global Compact).

Kodi i Sjelljes i Statkraft përcakton parimet themelore të DHP për sjellje të përgjegjshme. Furnitorët duhet të plotësojnë kërkesat e Kodit të Sjelljes së Furnitorëve të Statkraft.

Nëpërmjet aktiviteteve dhe operacioneve globale, Statkraft synon të krijojë vlerë për shoqërinë në tërësi, mjedisin dhe vetë kompaninë. Veprimi me përgjegjshmëri është një nga vlerat bërthamë të kompanisë. Njëkohësisht Statkraft është e vetëdijshme se kjo ambicie mund të sjellë dilema. Shoqëria përpiqet të kuptojë dhe të administrojë këto dilema nëpërmjet një përqasje të bazuar në vlerësimin e riskut, me balancimin e kujdesshëm të nevojave të ndryshme dhe duke i integruar këto konsiderata në proceset e biznesit të shoqërisë. Statkraft ndërmerr një qasje të kujdesshme në çështjet që lidhen me mjedisin, në të gjitha aktivitetet e biznesit. Kjo do të thotë se Statkraft kryen vlerësime të riskut, dhe zbaton masa zbutëse kur nevojitet.

Performanca kryesore në lidhje me qëndrueshmërinë në 2023 përfshin:

- Funksionimi i hidrocentralit të Banjës – kapacitet i instaluar i energjisë së rinovueshme 72 MW
- Funksionimi i hidrocentralit të Moglicës – kapacitet i instaluar i energjisë së rinovueshme 197 MW
- Ka filluar vlerësimi i zhvillimit të projekti RP Moglica Shtesë
- Statkraft ka vazhduar të identifikojë dhe vlerësojë ndikime të mundshme negative në të drejtat e njeriut dhe të punës në zinxhirin e furnizimit, përfshirë diskutime të vazhdueshme me furnitorët strategjikë
- Statkraft synon të zhvillojë një ambient pune të karakterizuar nga diversiteti dhe përfshirja dhe ka përcaktuar tre indikatorë kyç të ecurisë për promovimin dhe garantimin e krijimit të vlerave në afat të gjatë. Gjatë vitit 2023, masa kryesore përmirësimi kanë përfshirë rritjen e kompetencës dhe vetëdijes rreth diversitetit dhe përfshirjes, duke i integruar në procesin e rekrutimit dhe vendosjen e një strukture për ndjekjen e ecurisë dhe raportimin
- Ka vazhduar fokusin e lartë në lidhje me Shëndetin, Sigurinë, Mbrojtjen dhe Mjedisin (SHSMM) përmes programit "Fuqizuar nga kujdesi" ("Powered by care")
- Ka vazhduar vëmendja në fushën e etikës së biznesit dhe anti-korrupsionit me diskutime çdo tremujor mbi dilemat, trajnime dhe mësimi virtual për të gjithë punonjësit

STRATEGJIA

Zhvillimi i tregut

Gjatë dy viteve të fundit, në Evropë ka pasur një rritje të ndjeshme në çmimin e energjisë. Kjo është shkaktuar kryesisht nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia dhe pasojat e reduktimit të furnizimit me gaz në Evropë nga Rusia, reduktim që nisi nga gjysma e dytë e vitit 2021. Çmimet e energjisë së fundmi kanë pësuar rënie nga nivelet më të larta për shkak të uljes së kërkesës, furnizime shtesë të gazit nga Norvegjia dhe importet, si edhe një dimër relativisht i butë. Çmimet e gazit dhe energjisë janë ende në nivel më të lartë krahasuar me periudhën përpara luftës në Ukrainë. Zhvillimet e çmimit në periudhën afat-mesme varen kryesisht nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të karburanteve, si edhe kushtet e motit, zhvillime në kërkesën e industrisë dhe në tregun e karbonit. Sistemi energjetik i Evropës mbetet vulnerabil ndaj incidenteve si mungesa masive të gazit apo furnizimit me energji.

Megjithëse tregjet e energjisë kanë qenë jashtë të zakonshmes në dy vitet e fundit, drejtimi themelor i tranzicionit energjetik drejt një sistemi net-zero në dekadat në vijim po vazhdon. Në disa aspekte, kriza energjetike e ka përshpejtuar tranzicionin. Statkraft pret rritje masive në energjitë e rinovueshme në nivel global, si drejt vitit 2030 ashtu edhe drejt vitit 2050 dhe për të arritur objektivat klimatike nevojiten shumë teknologji të energjive të rinovueshme. Nxitësit kryesorë të për rritjen e energjive të rinovueshme në Evropë janë fokusi i lartë kundrejt dekarboizimit dhe sigurina e furnizimit me anë të p.sh. RePowerEU dhe objektivave net-zero, si edhe zëvendësimi i kapacitetit termik që po nxirret nga tregu për shkak të konkurrencës së ulët, kuadri ligjor dhe/ose mosha. Në tregjet në zhvillim nxitësi kryesor është një rritje e kërkesës për energji për shkak të rritjes ekonomike. Sistemi energjetik i së ardhmes pritet të dominohet nga energjitë nga dielli dhe era, të cilat pritet të përbëjnë më shumë se gjysmën e furnizimit global në vitin 2050.

Tranzicioni energjetik do të ndryshojë mënyrën se si prodhohet dhe konsumohet energjia elektrike. Rritja masive në energjitë diellore dhe të erës të cilat janë me ndërprerje, nxjerrja nga tregu e prodhimit me qymyr dhe rritja e konsumit, do të kërkojë më shumë prodhim fleksibël. Dekarbonizimi do të rrisë më tej kërkesën për teknologji të reja. Njëkohësisht, kompleksiteti dhe pasiguria në treg do të rriten si në afatet e shkurtra ashtu edhe në afatet e mesme. Strategjia e Statkraft është e ndërtuar mbi këto trende dhe avantazhet konkurruese të Shoqërisë në përpjekjet e saj të jetë kompani ndërkombëtare lider në energjinë e rinovueshme.

Pozicioni konkurrues i Statkraft

Statkraft është prodhuesi më i madh i energjisë së rinovueshme në Evropë si edhe ka një prani në rritje në tregje të tjera ndërkombëtare. Avantazhet konkurruese kyç të Statkraft dalin nga kuptimi i tregut nga kompania, kompetenca e saj industriale në zhvillimin dhe pronësinë e asetëve që prodhojnë energji dhe në aftësinë për të përdorur këto pika të forta në zinxhirin e vlerës.

Shoqëri e përgjegjshme e energjisë së rinovueshme
Statkraft ka një reputacion si shoqëri e përgjegjshme në energjinë e rinovueshme dhe shihet si partner kompetent me besueshmëri të lartë e etikën e biznesit. Statkraft përpiqet të zhvillojë dhe operojë projekte të rinovueshme në një mënyrë të qëndrueshme për mjedisin dhe shoqërinë ku operon.

Portofol fleksibël i madh dhe i veçantë

Kompetenca e fortë në optimizimin e përfitueshmërisë nëpërmjet administrimit të integruar të energjisë, operacioneve dhe proceseve të mirëmbajtjes, e bën DHP si pjesë e grupit Statkraft një zotëruar të shkëlqyeshëm të energjisë fleksibël hidrike.

Qëndrueshmëria financiare

Statkraft ka një themel të fortë financiar dhe ka treguar aftësinë për të pasur përfitueshmëri të qëndrueshme në tregje në ndryshim. DHP si pjesë e grupit Statkraft do të ketë një fokus të lartë në optimizimin e kostove teksa shoqëria vazhdon të rritet.

Prioritetet strategjike për DHP

Ofrimi i fleksibilitetit të pastër – duke përdorur hidroenergjinë

Nevoja për fleksibilitet në tregun e energjisë është në rritje, çka i jep Statkraft një avantazh unik si prodhues fleksibël i hidroenergjisë me ekspertizë të fortë në treg. Statkraft do të vazhdojë të ofrojë fleksibilitet të pastër – me anë të përdorimit të portofolit të saj të konsiderueshëm të hidroenergjisë. DHP është e angazhuar me grupet e interesit për të gjetur zgjidhje të cilat balancojnë nevojat mjedisore dhe shoqërore me përfitueshmërinë. DHP po vlerëson zhvillimin e një hidrocentrali të madh me sistemin e rezervës së pompuar, në kuadër të koncesionit ekzistues, projektin RP Moglica Shtesë.

Ambicia e DHP për 2030

DHP synon të jetë një shoqëri e fortë e energjisë nga burime të rinovueshme, me operacione të qëndrueshme, etike dhe të sigurta. Qëllimi do të jetë të:

- Jetë një prodhues i besueshëm i energjisë me një ekselencë operative në hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës, në përputhje me standardet lokale dhe ndërkombëtare
- Jetë një pjesëmarrës aktiv në aktivitetet e tregtisë, shitjen e elektricitetit në Evropën Juglindore dhe në tregje të tjera të rëndësishme. Të vazhdojë me marrëveshje dypalëshe në Shqipëri dhe të kërkojë të sigurojë marrëveshje afatgjata dypalëshe në tregje të tjera të rëndësishme
- Zhvillojë më tej potencialin e energjisë hidrike të kaskadës së Devollit, veçanërisht nëpërmjet vlerësimit të zhvillimit të projektit RP Moglica Shtesë
- Kontribuojë në diversifikimin e energjisë në Shqipëri duke eksploruar mundësitë e investimit në burime të energjisë nga burime të rinovueshme

Investimet

DHP është e fokusuar në iniciativat e krijimit të vlerave në Shqipëri, në përputhje me strategjinë e grupit Statkraft. Ecuria dhe vlera totale e investimeve në periudhën strategjike do të varet nga mundësitë dhe zhvillimi i tregut dhe do të përshtatet me kapacitetet financiare dhe vlerësimin e qëllimeve të Statkraft.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Bordi i Drejtorëve ka caktuar objektiva financiare dhe jo-financiare për DHP. Objektivat kryesore janë listuar në tabelën e mëposhtme. Ecuria e lidhur me disa nga synimet do të vlerësohet në një hark kohor më të gjatë.

Kujdesi për njerëzit është në bazë të veprimtarisë së DHP dhe DHP punon vazhdimisht drejt synimit prej zero lëndime. Nuk ka pasur incidente me lëndime serioze në vitin 2023.

DHP ka tolerancë zero për korrupsionin dhe praktikat jo-etike në të gjitha veprimtaritë, dhe nuk ka pasur incidente serioze të pajtueshmërisë në 2023.

Vlerësimi i rreziqeve mjedisore është pjesë e procedurave dhe praktikave të përditshme të administrimit të rrezikut të DHP dhe nuk ka pasur incidente serioze mjedisore në 2023.

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI 2023
Shëndeti, Siguria, Mjedisi dhe qëndrueshmëria		
Shmangia e incidenteve dhe të qenit të angazhuar në vendin e punës pa lëndime dhe dëme	Zero lëndime serioze	0
Shmangia e korrupsionit dhe praktikave jo-etike në të gjitha veprimtaritë	Zero incidente serioze pajtueshmërie	0
Ofrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë miqësore me klimën dhe marrja e masave të përgjegjshme	Zero incidente serioze mjedisore	0

ECURIA FINANCIARE

Në vitin 2023, të ardhurat bruto të DHP-së u ulën për shkak të uljes së çmimit të energjisë.

Prodhimi total i energjisë elektrike gjatë vitit 2023 ishte 480 547 MWh, reduktim prej rreth 30% krahasuar me vitin 2021 për shkak të hidrologjisë së pafavorshme.

Në fund të vitit 2023, kapitali i Shoqërisë ishte 90 637 351 mijë Lekë, që i korrespondon 99% të aktiveve totale.



Zërat e paraqitur më poshtë janë matës alternative të ecurisë, shiko kapitullin "Matje Alternative të Ecurisë" për qëllimin, përkufizimin dhe përcaktimin e të gjithë zërave. Elementët nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse pas fitimit operativ janë analizuar në përputhje me pasqyrat financiare.

Të ardhurat neto nga shfrytëzimi

Të ardhurat e DHP gjenerohen nga shitjet spot dhe aktivitetet e tregut. Baza themelore për të ardhurat e DHP përbëhet nga çmimet e energjisë, optimizimi i energjisë dhe prodhimi. Të ardhurat nga prodhimi optimizohen përmes tregtisë financiare të energjisë dhe DHP angazhohet në aktivitete tregtimi të lidhura me energjinë. Të ardhurat neto nga shfrytëzimi janë një kombinim ndërmjet shitjeve në vend dhe eksportit.

Shpenzimet operative

Në vitin 2023, shpenzimet operative të Shoqërisë janë ulur krahasuar me një vit më parë. Shpenzimet operative në vitin 2022 janë rritur kryesisht për shkak të Ligjit të ri për Kontributin e Solidaritetit në Shqipëri.



Zërat financiarë

Zërat financiarë përbëhen kryesisht nga humbjet neto prej kurseve të këmbimit. Efekti negativ është kryesisht si rezultat i një forcimi të Lekut ndaj Euros.

Shpenzimi i tatim fitimit

Gjatë vitit 2023, DHP ka operuar asetet e saj gjatë gjithë vitit, me HEC Moglicë që filloi operimet tregtare nga viti 2020, ndërsa hidrocentrali i Banjës ka filluar operimet tregtare në 2016.

DHP ka regjistruar fitim neto për vitin 2023 prej 6 044 068 mijë Lekë dhe ka paguar Tatim mbi Fitimin në masën 77 812 mijë Lekë.

Flukset monetare

Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit ishin (1 175 613) mijë Lekë. Rënia erdhi kryesisht si rezultat i ndryshimeve në përlogaritjen e të ardhurave të tjera dhe shpenzimeve, përfshirë pagesën e Kontributit të Solidaritetit dhe taksave të tjera.

Gjithashtu, forcimi i Lekut ndaj Euros dha një ndikim prej (1 110 594) mijë Lekë.

Flukset monetare nga aktivitetet e financimit nuk ishin domethënëse.

Në fund të vitit, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to ishin në shumën e 11 232 081 mijë Lekë.



Ngjarje të rëndësishme në 2023

- Kushte hidrologjike të pafavorshme në Luginën e Lumit Devoll me ulje të konsiderueshme të prurjeve ujore në rezervuarët e Banjës dhe Moglicës, çka ka rezultuar me ulje të sasisë së prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet.
- Çmime të larta të energjisë elektrike në tregjet ku operon DHP.
- Zbatim i Ligjit të ri për Kontributin e Solidaritetit.
- Viti i plotë me operime nga të dy HEC-et, Banja dhe Moglicë.
- Amendim i Kontratës së Koncesionit me Autoritetin Kontraktues për zhvillimin e projektit RP Moglica Shtesë (hidrocentral me sistemin e rezervës së pompuar).

Fuqia financiare dhe vlerësimi i Grupit

Statkraft vlerësohet nga Standard & Poor's dhe Fitch. Pas një rritje në vitin 2022, vlerësimi aktual i kreditit të Statkraft AS është me notën A (perspektivë e qëndrueshme) nga Standard & Poor's dhe me notën A- (perspektivë e qëndrueshme) nga Fitch Ratings. Rritjet e vlerësimeve në vitin 2022 ishin si pasojë e çmimeve të larta të energjisë dhe parashikimit më të lartë të fitimit. Statkraft e vlerëson rritjen e vlerësimit pozitiv por mbetet e angazhuar ndaj një objektivit të vlerësimit me notën A- nga Standard & Poor's dhe BBB+ nga Fitch Ratings.

VIJIMËSIA

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Bordi i Drejtorëve konfirmon që pasqyrat financiare vjetore janë përgatitur me supozimin që shoqëria do ketë vijimësi, dhe se ky supozim është i saktë.

KËRKIMI DHE ZHVILLIMI

Aktivitetet e Kërkim – Zhvillimit do të mundësojnë njohuri dhe zgjidhje për operacionet vijuese.

Sa i përket energjisë së burimeve ujore, aktivitetet e Kërkim – Zhvillimit do të mbështesin operacionet dhe mirëmbajtje të optimizuara dhe fleksibilitet të shtuar. Kërkim – Zhvillimi do të luajë një rol jetësor në të kuptuarit e pamjes së energjisë së të ardhmes, duke përfshirë se si efektet klimatike do të ndikojnë në operacionet dhe tregjet në të gjitha teknologjitë. Në këtë pamje, kërkimi i shkencës shoqërore po bëhet më i rëndësishëm. Kështu, ne kërkojmë njohuri të reja mbi sjelljet e konsumatorit dhe shoqërisë për të përmirësuar të kuptuarit tonë mbi sfidat në ndërlidhjen midis shoqërisë dhe grupit Statkraft.

Në këtë kuadër një projekt inovativ i Kërkim – Zhvillimit u realizua në Shqipëri nga Statkraft Renewables Albania Shpk. Impianti Fotovoltaik Lundruer i Banjës konsiston në katër njësi lundruese me panele fotovoltaike të instaluar mbi një membranë lundruese, me kapacitet total të instaluar prej 2 MWp. Projekti përfundoi në vitin 2022 dhe aktualisht po prodhon energji të rinovueshme në Shqipëri.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT

DHP është e ekspozuar ndaj rreziqeve përgjatë zinxhirit të vlerës. Rreziqet më të rëndësishme janë të lidhura me çmimet e tregut, rrezikun financiar, Shëndetin, Sigurinë, Mbrojtjen dhe Mjedisin (SHSMM), aktivitetet e shfrytëzimit.

Administrimi i rrezikut është pjesë e integruar e modelit të drejtimit të DHP. Shoqëria ka një përfaqje të bazuar në rrezik në përcaktimin e synimeve, prioritetëve dhe ndjekjen në fushën e biznesit dhe stafit. Administrimi i përditshëm i rrezikut është një përgjegjësi e vijueshme. Rreziqet e përgjithshme të Shoqërisë rishikohen dhe ndiqen nga Drejtimi i Shoqërisë dhe raportohen në Bordin e Drejtorëve. DHP bën një vlerësim të hollësishëm të cilësisë përpara investimeve, shitjeve dhe blerjeve.

Bordi i drejtorëve të shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj të trajnimit dhe drejtimit synon të mbajë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre.

Rreziku i aktivitetit

Të gjitha proceset përgjatë zinxhirit të vlerës janë të ekspozuara ndaj rrezikut të aktivitetit. Rreziku i aktivitetit është më i lartë në zbatimin e projekteve të investimit, aktiviteve të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtës si dhe aktiviteve të tregut. Kjo mund të sjellë:

- Dëmtime tek punonjësit, kontraktorët dhe palët e treta
- Ndikime mjedisore dhe sociale
- Shkelje të pajtueshmërisë
- Dëmtim dhe humbje të centraleve tona të prodhimit dhe të palëve të treta dhe të aktiveve të tjera
- Reputacion i dobësuar
- Humbje ekonomike

Angazhimi i DHP-së rreth sigurisë, qëndrueshmërisë, dhe praktikave të përgjegjshme të biznesit përbën themelin e çdo aktiviteti. DHP ka një vëmendje të lartë në kryerjen e aktiviteve të zhvillimit dhe operimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të parandalojë humbje financiare. Një kulturo e fortë biznesi është themeli i përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi rezistent të parandalimit dhe kontrollit. Prioritet i lartë i kushtohet garantimit të aktiviteve të zhvillimit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Rreziku i aktivitetit administrohet përmes procedurave dhe kontrolleve të aktiviteve dhe proceseve, duke projektuar zgjidhje teknike, zhvilluar kompetencat dhe në llojet e ndryshme të planeve rezervë. Për më tepër, DHP ka një sistem gjithëpërfshirës për regjistrimin dhe raportimin e rrezikut, kushtet e rrezikshme, incidentet e padëshirueshme, dëmtimet dhe lëndimet. Të tilla raste analizohen vazhdimisht në mënyrë që të parandalohet dhe të kufizohet çdo pasojë negative, dhe të sigurohet që mund të ndjekim shkaqet dhe të marrim masat e nevojshme.

Infrastruktura e DHP dhe aplikacionet janë të ekspozuara ndaj krimit kibernetik dhe kërcënimeve të tjera të jashtme dhe procedurat, kompetencat dhe sistemet e Shoqërisë përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për të forcuar qëndrueshmërinë përballë incidenteve të tilla.

DHP kryen vazhdimisht vlerësime të rrezikut. Zbatimi i administrimit të rrezikut në fazat e hershme të zhvillimit të biznesit dhe projektit është një faktor i rëndësishëm i suksesit.

Pasojat e mundshme financiare të rrezikut total të aktivitetit, si dhe rreziqe të rëndësishme individuale, janë tregues kryesorë të profilin të rrezikut të përgjithshëm të Shoqërisë. DHP ka mbulim nga sigurimi për të gjitha rastet e rëndësishme të dëmtimeve ose lëndimeve nga aktiviteti.

Rreziku i tregut të energjisë

Statkraft është e ekspozuar ndaj një rreziku domethënës në aktivitetet e saj të prodhimit dhe tregtimit të energjisë:

- Si vëllimet e prodhimit ashtu edhe çmimet e energjisë ndikohen nga kushtet e motit, konsumi dhe kushtet e transmetimit në tregjet e energjisë.
- Çmimet e energjisë ndikohen edhe nga çmimet e karburanteve si gazi, qymyri dhe nafta, përtej çmimit për emetimet e kuotave të karbonit, skemave mbështetëse, rritjes së kërkesës dhe futja e zhvillimi i teknologjive të reja.

Pasiguria dhe perspektiva në tregjet e energjisë dhe çmimin e saj monitorohet dhe analizohet në vazhdimësi për të garantuar menaxhim optimal të energjisë, operimeve tregtare dhe investimeve fitimprurëse.

Statkraft e menaxhon riskun e tregut në tregjet e energjisë duke ndërmarrë pozicione në tregjet e energjisë dhe produkteve që lidhen me të, qoftë financiarisht, apo nëpërmjet kontratave dypalëshe. Integrimi i shtuar i tregjeve të energjisë po shkakton një ndikim domethënës në modelet e biznesit dhe menaxhimin e riskut. Si pasojë, Statkraft i kushton një rëndësi të veçantë identifikimit të lidhjeve ndërmjet tregjeve të ndryshme. Strategjitë mbrojtëse të Grupit rregullohen nga kufizime të përcaktuara rreth vlerave dhe volumeve të pozicioneve dhe nga kriteret për vlerësimin e kontratave të reja kundrejt të ardhurave të pritshme dhe riskut respektiv. Portofoli përshtatet në vazhdimësi lidhur me pritshmëritë e përditësuara të çmimeve të ardhme dhe kapacitetit prodhues të vetë Shoqërisë.

Aktivitetet e Statkraft në tregtimin e energjisë dhe shërbimeve konsistojnë si në tregtimin e produkteve standarde në bursat e energjisë ashtu edhe në shitjen e shërbimeve apo produkteve të përshtatura për klientë individualë. Risku trajtohet nëpërmjet mandateve që mbulojnë produktet e energjisë, zonat gjeografike dhe kohëzgjatjet. Një funksion i administrimit të riskut siguron objektivitet në vlerësimin dhe trajtimin e riskut.

Rreziku financiar

Rreziku financiar i lidhur me valutat e huaja, normat e interesit, likuiditetin dhe financimin koordinohet dhe administrohet në nivel grupi.

Aktivitetet e DHP në Shqipëri janë të ekspozuara ndaj riskut të valutës (kursit të këmbimit), pasi aktivitetet e tregtimit të energjisë realizohen kryesisht në Euro dhe disa nga aktivitetet / detyrimet në vend realizohen në Lekë. Ky risk kanë qenë më i dukshëm në vitet e fundit, gjatë të cilave kursi i këmbimit ndërmjet Euros dhe Lekut ka pasur ndryshime domethënëse.

Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i një humbje financiare nga Shoqëria në rast se një klient apo një palë në një instrument financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe krijohet kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Llogaritë e arkëtueshme

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditimit është influencuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, drejtimi merr gjithashtu në konsideratë edhe faktorët që mund të influencojnë rrezikun kreditor të tyre si konsumatorë, duke përfshirë rrezikun e falimentimit të shoqëruar me rrezikun e industrisë dhe vendit në të cilin klientët kryejnë aktivitetet.

Kufizimet për kontratat e energjisë, janë përcaktuar individualisht për palën tjetër duke përdorur një vlerësim të brendshëm të kreditit. Palët janë ndarë sipas kategorive të ndryshme. Vlerësimi i brendshëm i kreditit është bazuar në të dhënat financiare të rëndësishme (modeli i vlerësimit i kryer nga Shoqëria/opinionit i ekspertit), vlerësimet e jashtme dhe probabilitetet e mos-arkëtimit të blera nga ofrues të jashtëm.

Kontratat dypalëshe janë subjekt i kufizimeve për çdo palë tjetër për sa i përket vëllimit, sasisë dhe kohëzgjatjes. Rreziku për palën tjetër nga këto kontrata konsiderohet të jetë shumë i ulët.

Kufijtë e ekspozimit individual të çdo pale tjetër monitorohen vazhdimisht dhe i raportohen rregullisht drejtimit. Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditit nga llogaritë e arkëtueshme tregtare, duke vendosur një periudhë maksimale të pagesës nga një deri në tre muaj respektivisht për palët e lidhura dhe klientët e palëve të tjera. Kufijtë e kreditit mund të ulen duke pranuar mbështetjen e kreditit në formën e një Garancie nga Shoqëria Mëmë dhe/ose Garanci Bankare.

Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit nga llogaritë e arkëtueshme duke vendosur një afat maksimal për kryerjen e pagesave, që është gjashtë muaj për klientët e zakonshëm dhe një muaj për korporatat.

Pothuajse të gjithë klientët e Shoqërisë kryejnë transaksione me Shoqërinë prej gjashtë vitesh, që nga fillimi i aktivitetit të saj dhe asnjë balancë e këtyre klientëve nuk është çregjistruar ose zhvlerësuar në datën e raportimit. Në monitorimin e rrezikut të kreditimit për klientët, ato janë grupuar sipas karakteristikave të detyrimeve të tyre, ku përfshihet nëse janë palë të lidhura, klientë të tjerë, rajonet e tyre gjeografike, historiku i tregtisë me Shoqërinë dhe ekzistenca e vështirësive të mëparshme financiare.

Rreziku rregullator dhe i vendndodhjes

Aktivitetet e DHP në Shqipëri janë të ndikuara nga kushtet kufizuese të tilla si tarifatat, kushtet për koncesionin, rregulloret dhe kërkesat për rrjetet e energjisë dhe përcaktimet e vendosura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Rreziku i ndryshimeve legjislativ mund të sjellë gjoha, kufizime dhe/ose humbje të mundësive duke ndikuar në zbatimin e projektit dhe prodhimin e DHP-së, kostot dhe të ardhurat. DHP bën përpjekje të qenësishme në analizimin se cilat mund të jenë efektet e mundshme në fushën në të cilën operon dhe vazhdimisht ndërmerr veprime për zvogëlimin e rrezikut.

DHP është gjithashtu e ekspozuar drejtpërdrejt ndaj kushteve të kuadrit legjislativ të tilla si shkallët e taksimit, kushtet e licencave dhe rregullave publike. Rreziku i

ndryshimeve të mundshme në kuadrin politik mund të sjellë një mjedis më sfidues biznesi, çka do të përkthehej në mos përbushjen e afateve të shoqëruar edhe me humbje financiare. Si pasojë DHP thekson rëndësinë e ndjekjes së zhvillimeve të këtyre faktorëve dhe po merr masa në koordinim me drejtimin e palëve të interesuara.

Një proces i zakonshëm i vlerësimit të rrezikut është zbatuar për të siguruar një administrim gjithëpërfshirës dhe proaktiv të rrezikut të biznesit. Vlerësimi i rrezikut mbulon aspekte politike dhe ligjore, zhvillimin shoqëror, sigurinë, pajtueshmërinë, regjimin tatimor dhe legjisllacionin për biznesin. DHP ndjek në mënyrë të rreptë standardet e Statkraft dhe ka implementuar një sistem për të siguruar pajtueshmërinë në të gjitha veprimtaritë dhe ka zero tolerancë ndaj korrupsionit. DHP është një tregtues aktiv i energjisë në rajon, duke qenë kështu e ekspozuar në mënyrë direkte ndaj ndryshimeve në kuadrin rajonal të tregtisë së energjisë, veçanërisht ndaj ndryshimeve në tarifatat mbi import / eksportin e energjisë.


DHP monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e tregut të energjisë në rajon në mënyrë që të përshtatet me zhvillimet përkatëse, në përputhje me kërkesat dhe praktikatat e Statkraft. Shoqëria kryen vlerësime të rrezikut në mënyrë të rregullt për zhvillimet rajonale.

Rreziku i ndryshimeve klimatike

Tranzicioni drejt një ekonomie me intensitet të ulët karboni do të shoqërohet me ndryshime të qenësishme të politikave, legjisllacionit, të teknologjisë dhe tregut, me potencialin për të pasur ndikim domethënës në të ardhurat e Statkraft. Edhe nëse portofoli dhe strategjia e Statkraft janë të përshtatura mirë për një të ardhme me intensitet të ulët karboni, Shoqëria ka ende ekspozim domethënës kundrejt disa prej risqeve të lidhur me klimën.

Statkraft ndikohet drejtpërdrejt nga ndryshimet klimatike, pasi prodhimi mesatar nga centralet e energjisë së rinovueshme mund të ndryshojë dhe probabiliteti i ngjarjeve të motit ekstrem që sfidojnë integritetin fizik të centraleve do të rritet. Statkraft është gjithashtu e ekspozuar ndaj ndryshimeve të tregut që nxiten nga masat politike për reduktimin e emetimeve nga sektori i energjisë dhe sektorë të tjerë industrialë. Ky ekspozim vjen kryesisht nga masat që ndikojnë çmimin e energjisë dhe rrjedhimisht të ardhurat e Statkraft. Subvencionet për kapacitetin e rinovueshëm mund të çojnë në mbi-kapacitet dhe çmime më të ulëta, ndërsa rritja e kostove të emetimeve do të çojë në çmime më të larta të energjisë. Edhe masat e drejtpërdrejta për nxjerrjen nga funksioni të karburanteve fosile do të kenë një ndikim në çmim, pasi do të ndryshojnë ekuilibrin e tregut. Ka edhe një risk të lidhur me emetimet e vetë Statkraft, pasi rregulloret mund të rrisin koston e këtyre emetimeve. Statkraft mund të ndikohet edhe nga ndryshime në preferencat e konsumatorëve nga vetëdija e rritur publike.

Ndryshimet klimatike vlerësohen si pjesë integrale e aktivitetëve për administrimin e riskut në Statkraft, si nxitës në faktorët relevant të riskut si parashikimet e çmimeve, aktivitetet e shfrytëzimit dhe vendimeve për investime.



Statkraft synon të jetë një nga shoqëritë lider në botë në fushën e energjive të rinovueshme në vitin 2030. Ambicia jonë është të kontribuojmë për një të ardhme më të qëndrueshme duke sjellë energjinë e rinovueshme pranë industrive, bizneseve, komuniteteve dhe shtëpive në mbarë botën.



Qëndrueshmëria

2023

Qëndrueshmëria

ADMINISTRIMI I QËNDRUESHMËRISË

Rinvojmë energjinë që fuqizon botën

Aspirata e Statkraft për vitin 2030 është të jetë një shoqëri lider në rang ndërkombëtar për energjinë – duke krijuar vlerë dhe mundësuar një të ardhme net-zero. Kjo thekson angazhimin e fortë të Statkraft ndaj qëndrueshmërisë. Nëpërmjet aktiviteteve tona, Statkraft synon të krijojë vlerë për shoqërinë, mjedisin dhe biznesin. Vizioni ynë i përditësuar është 'rinvojmë energjinë që fuqizon botën'.

Mënyra se si bëjmë biznes është e rëndësishme për të arritur këtë strategji ambicioze të rritjes. Statkraft e integron qëndrueshmërinë në gjithçka që bëjmë. Strategjia jonë e qëndrueshmërisë përfshin qasjen tonë tërësore ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me çështjeve materiale si ndryshimi i klimës, biodiversiteti dhe të drejtat e njeriut.

DHP si pjesë e grupit Statkraft është e angazhuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike nëpërmjet bërthamës së biznesit të saj, ofrimi i energjisë së rinovueshme nga uji dhe eksplorimi i zgjidhjeve të reja në energji. Strategjia e biznesit të DHP është e bazuar në zhvillimin e veprimtarisë në mënyrë të sigurt, etike dhe të përgjegjshme.

Statkraft është njëherazi e angazhuar në garantimin e një tranzicioni të drejtë. Kjo do të thotë se ne, në tranzicionin drejt një shoqërie të gjelbër, marrim në konsideratë ndikimin ndaj planetit dhe njerëzve. Mënyra se si bëjmë biznes është thelbësore në këtë drejtim, me një kulturë të fortë të sigurisë dhe shëndetit në punë, fokus ndaj diversitetit dhe përfshirjes, standarde të larta etike, kushte të drejta pune dhe tolerancë zero ndaj korrupsionit. Statkraft punon edhe për të rritur në vazhdimësi kuptimin e ndikimit tonë ndaj njerëzve, mjedisit dhe shoqëritë ku punojmë, qoftë pozitiv apo negativ,

Teksa Statkraft ka zhvilluar energji të rinovueshme për më shumë se një shekull, angazhimi ynë ndaj qëndrueshmërisë është në bërthamën e biznesit tonë. Bazohemi në përvojën tonë të gjatë teksa vazhdojmë të zhvillojmë administrimin dhe strategjinë e qëndrueshmërisë për të mundësuar një të ardhme net-zero, duke zbatuar ligjet e reja dhe duke marrë në konsideratë rritjen e pritshmërisë së grupeve të interesit.

Drejtimi

Veprimi me përgjegjshmëri është një nga vlerat tona themelore. Parimet themelore për sjellje të përgjegjshme janë përshkruar në Kodin e Sjelljes të grupit Statkraft i cili është miratuar nga Bordi i Drejtuesve. Kodi zbatohet për të gjitha shoqëritë e grupit Statkraft dhe të gjithë individët të cilët punojnë për këto shoqëri. Partnerët tanë të biznesit pritet t'i përmbahen standardeve në përputhje me Kodin e Sjelljes së Furnitorëve të Statkraft.

Parimet përshkruhen më tej në dokumentet e drejtimit në sistemin tonë të menaxhimit "The Statkraft Way". Ky sistem përcakton drejtimin e punës tonë dhe rishikohet e përditësohet rregullisht teksa evoluojnë rregulloret dhe pritshmëria.

Gjithashtu kemi një sistem për regjistrimin dhe ndjekjen e mos-pajtuësishmërisë me kërkesat e brendshme dhe të jashtme. Sistemi lehtëson administrimin e çështjeve, analizën e incidenteve, identifikimin e përmirësimeve, dhe mësimin e vazhdueshëm në Shoqëri.

Dialogu me grupet e interesit

DHP synon të ketë një dialog të hapur mbi çështjet e qëndrueshmërisë me palët e interesuara të ndikuara nga veprimtaria jonë. Palët të interesuara të rëndësishme në këto biseda përfshijnë zyrtarët shtetërorë, autoritetet lokale dhe rajonale, komunitetet lokale, punonjësit, klientët, furnitorët, institucionet kërkimore, organizatat jo-qeveritare, organizatat vullnetare dhe median.

Dialogu me palët e interesuara është pjesë e veprimtarive ditore, duke filluar nga ndërveprimi i zakonshëm me palët e interesuara në vendndodhjet e projekteve tona, në anëtarësim në forumet dhe platformat e qëndrueshmërisë aleancat dhe partneritetet si:

- Kryerja e konsultimeve me grupet e interesit e prekur direkt ose indirekt nga aktivitetet tona
- Organizim i takimeve konsultuese të hapura dhe publike
- Pasja e një mekanizmi eficient dhe transparent të trajtimit të ankesave për projektet në ndërtim dhe operim
- Promovimi i përmirësimeve të qëndrueshme nëpërmjet pjesëmarrjes në shoqatat dhe iniciativat e industrisë

Administrimi i përgjegjshëm i zinxhirit të furnizimit

Statkraft ka një angazhim të fortë ndaj praktikave të përgjegjshme të biznesit dhe ky ai shtrihet edhe në zinxhirin e furnizimit. Kodi ynë i Sjelljes së Furnitorit është pjesë e të gjitha kontratave. Ai bazohet në standarde të njohura ndërkombëtarisht, që përfshijnë kërkesa për respektimin e të drejtave të njeriut, shëndetit dhe sigurisë, të drejtat e punës, kushtet e punës, mjedisit, privatësisë, lirisë së shprehjes dhe praktikave e ndaluara të biznesit. Furnitorët pritet që të plotësojnë këto kërkesa përgjatë marrëdhënies me DHP-në. Furnitorët informohen për Kodin e Sjelljes së Furnitorit gjatë procesit të prokurimit dhe ai është pjesë e kontratave.

DHP ka një shumëllojshmëri furnitorësh duke filluar nga shoqëri të mëdha ndërkombëtare tek furnitorë më të vegjël lokalë në kategori të ndryshme industrish. Për administrimin e rreziqeve më të rëndësishëm në zinxhirin e furnizimit, DHP ka adoptuar një përjasje të bazuar në rrezik për kualifikimin paraprak dhe kontraktimin e furnitorëve. Janë caktuar pragje globale dhe lokale për të përqendruar përpjekjet aty ku rreziqet në zinxhirin e furnizimit janë më të larta. Objektivi kryesor është të sigurojë që të bëhen furnitorë shoqëritë të cilat plotësojnë standardet e DHP-së. Të gjithë furnitorët i nënshtrohet kontrollit të integritetit në platformën Dow Jones Risk Center.

Kur zbulojmë një ndikim negativ lidhur me prokurimin e produkteve apo shërbimeve, angazhohemi me dialog me furnitorët që situata të ndalet, zbutet dhe/ose korrigjohet. Veç kësaj, ne rivlerësojmë marrëdhënien me furnitorin dhe shqyrtojmë nëse ajo duhet ndërprerë.

Kontributi i DHP

Ne aspirojmë të jemi një Shoqëri ndërkombëtare lider në energjinë e rinovueshme në vitin 2030 – duke krijuar vlerë me mundësimin e një të ardhme net-zero.

Shumica e emetimeve të gazrave në botë janë të lidhura me energjinë. Kështu rritja e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme është kritike për të arritur synimet e emetimeve globale. Për më tepër, elektrifikimi i bazuar në energjinë e rinovueshme është një element kryesor për të luftuar ndryshimet klimatike. DHP është pjesë e zgjidhjes për një botë me energji të pastër.

Aktivitetet e DHP kontribuojnë në mënyra të ndryshme në ekonomitë globale, kombëtare dhe lokale përmes ndarjes së dividendëve për aksionerët, taksat e paguara ndaj qeverive, punësimit direkt, aktiviteteve tona globale dhe lokale të prokurimit, Kërkim & Zhvillimit dhe investimeve sociale. Përjasja jonë për sjelljen e përgjegjshme të biznesit kontribuon në promovimin e praktikave të mira të biznesit. Ne gjithashtu kërkojmë të ndajmë njohuritë rreth energjisë së rinovueshme, sistemeve të energjisë, ndryshimeve klimatike dhe çështjeve mjedisore.

Prodhimi i energjisë nga DHP realizohet nga burime të rinovueshme (ujore). Energjia e ujit ka shume avantazhe, duke përfshirë efikasitetin e lartë, kostot e ulëta të shfrytëzimit, jetëgjatësinë, fleksibilitetin e lartë dhe intensitetin e ulët të

karbonit. Rezervuarët e mëdhenj të ujit mundësojnë mbajtjen dhe prodhimin e energjisë edhe në periudhat e prurjeve të reduktuara ose të ulëta. Kjo jep fleksibilitet në prodhimin e energjisë.

Zhvillimi dhe shfrytëzimi i hidrocentraleve lehtëson përdorimet e shumta të rrjedhave ujore dhe infrastrukturës për shembull ujitjen, furnizimin me ujë të pijshëm, transportin dhe zbavitjen. Për më tepër, përdorimi i rezervuarëve për kontrollin e përmbytjeve bëhet akoma më i rëndësishëm teksa klima ndryshon.

Politika e Statkraft për taksat

Grupi Statkraft ndjek një strategji tatimore e cila është parimore, transparente dhe e qëndrueshme. Ajo miratohet nga Bordi i Drejtorëve dhe publikohet në website të Statkraft. Strategjia tatimore vlerësohet rregullisht nga Departamenti i Tatimeve të Grupit Statkraft dhe çdo ndryshim në strategjinë tatimore i paraqitet bordit për shqyrtim dhe miratim.

Strategjia jonë tatimore bazohet në parimet themelore që tatimet duhet të paguhen aty ku prodhohet vlera ekonomike, se rregullimet tatimore janë përgjegjësi e bordit dhe se raportimi vend-pas-vendi është element thelbësor i publikimeve tatimore të korporatës. Statkraft beson se sjellja tatimore e përshtatshme, e kujdesshme dhe transparente është element kyç i praktikave të përgjegjshme të biznesit. Rrjedhimisht, kemi pritësinë se partnerët tanë të biznesit të zbatojnë standarde të ngjashme rreth tatimeve dhe transparencës brenda organizatave të tyre duke njohur se Statkraft angazhohet me partnerë të ndryshëm biznesi.

Statkraft ka një përjasje tatimore në një mënyrë që përputhet me strategjinë tonë të biznesit e cila synon reduktimin e kompleksitetit të biznesit dhe koston. Ne nuk angazhohemi në marrëdhënie artificiale për tatimet dhe i konsiderojmë në mënyrë aktive të gjitha implikimet në planifikimin rreth tatimeve. Për më tepër, i gjithë planifikimi tatimor duhet të jetë në përputhje me kuadrin e Optimizimit dhe Strukturimit Tatimor të Grupit, i cili qeveris qasjen tonë ndaj planifikimit tatimor dhe është objekt i proceseve të rrepta të vlerësimit dhe miratimit. Ne nuk përdorim juridiksione me barrë të ulët tatimore për të shmangur tatimet dhe krijojmë një njësi biznesi në një juridiksion me barrë të ulët apo zero vetëm për arsye thelbësore apo të tregtare. Kjo do të thotë se ne i paguajmë tatimet sipas parimit se ku krijohet vlera gjatë ushtrimit normal të aktivitetit tonë tregtar.

Statkraft është e angazhuar për të garantuar pajtueshmëri të plotë me të gjitha detyrimet ligjore dhe hapje të plotë ndaj organeve tatimore. Ne angazhohemi me autoritetet tatimore me ndershmëri dhe integritet dhe përpiqemi të vendosim një marrëdhënie bazuar në respektin reciprok, transparencën dhe besimin. Bashkëpunojmë me autoritetet tatimore kurdo që është e mundur për të zgjidhur mosmarrëveshje dhe të arrijmë qartësi, por jemi të gatshëm të kërkojmë mbrojtje gjyqësore atëherë kur kemi kundërshtime me një vendim apo urdhër. Statkraft angazhohet në mënyrë konstruktive dhe me integritet me qeveritë rreth zhvillimit të sistemit tatimor, legjisacionit dhe administrimit, qoftë direkt apo nëpërmjet shoqatave të industrisë, sipas rastit. Ne besojmë se arrihen rezultate më të informuara dhe të qëndrueshme kur qeveritë konsultohen në mënyrë të hapur me industrinë dhe grupe të tjera të interesit që preken.

SI I PROMOVOJMË PRAKTIKAT E PËRGJEGJSHME TË BIZNESIT

Shëndeti dhe Siguria

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Të evitohet incidentet dhe të jetë e angazhuar në një mjedis pa lëndime apo dëmtime	Zero lëndime serioze	0 ●
Komente mbi ecurinë <ul style="list-style-type: none"> Nuk ka pasur lëndime serioze në vitin 2023. Programi "Fuqizuar nga Kujdesi" ("Powered by Care") dhe përpjekjet për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme shëndetin dhe ecurinë e sigurisë dhe kulturën do të vazhdojnë të kenë një vëmendje në të ardhmen. Elementë kryesorë përfshijnë SHSMM, drejtimin, Rregulla për Ruajtjen e Jetës për veprimtaritë me rrezikshmëri të lartë, një kuadër të përmirësuar për Administrimin e SHSMM, kërkesa të përmirësuar SHSMM për prokurimin, futja dhe zbatimimi i Autoritetit për të ndaluar punën e pasigurt nga CEO, SHSMM e ritur në projekte, dhe kërkesa të qarta dhe efektive për SHSMM. 		
Iniciativat kryesore <ul style="list-style-type: none"> Të sigurojë udhëheqje dhe të drejtë ndryshim kulturor në të gjitha nivelet. Të inkurajojë dhe të masë administrimin dhe angazhimin e punonjësve. Të forcojë fokusin në veprimtaritë me rrezikshmëri të lartë dhe në masat parandaluese. Të sigurojë trajnime për të fituar kompetencat e kërkuara. Të sigurojë të mësuarit dhe ndarjen e eksperiencave nga incidente me potencial të lartë rreziku. 		

Përqasja jonë

Kujdesi për njerëzit është baza e kulturës së DHP dhe ne punojmë vazhdimisht drejt qëllimit tonë prej zero lëndime. DHP ka një program për të zbatuar përmirësimet në shëndetin dhe sigurinë e të gjithë organizatës, i quajtur "Fuqizuar nga Kujdesi" ("Powered by Care"). Drejtimi i korporatës së DHP demonstroi qartë angazhimin e tyre për një mjedis pune pa lëndime dhe dëmtime siç komunikohet në deklaratën e tyre të angazhimit në programin "Fuqizuar nga Kujdesi" ("Powered by Care").

Rreziqet kryesore

Rreziqet e lidhura me shëndetin dhe sigurinë vijnë nga veprimtaritë e DHP në projekte ndërtimi, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e centraleve dhe pajisjeve të tjera, nga prania jonë në vende gjeografike të ndryshme, nga udhëtimet dhe veprimtaritë e tjera të biznesit. Fushat mbizotëruese me rrezik të lartë janë të lidhura me lëndimet e personelit nga aksidentet në mjedisin e punës. Veprimtaritë e lidhura me udhëtimin me makinë, punën në lartësi, operacionet e ngritjes, sistemet e energjisë, pajisjet e rënda të lëvizshme, punët në tokë dhe të punuarit në hapësira të mbyllura konsiderohen të kenë rrezikshmërinë më të lartë.

Statusi 2023

Nuk ka pasur lëndime serioze në vitin 2023.

Në vitin 2023, treguesi "Lëndime me humbje kohe (treguesi LTI)" ishte 0 për punonjësit e DHP dhe për kontraktorët e DHP-së.

Treguesi Total i Lëndimeve të Regjistruara (treguesi TRI) për punonjësit e DHP dhe për kontraktorët e DHP ishte 0.

Leje për arsye shëndetësore

Lejet për arsye shëndetësore në DHP janë në një nivel të ulët të qëndrueshëm në vitin 2023, nën synimin prej 3.5%.

Programi i përmirësimit të Shëndetit dhe Sigurisë

Në vitin 2023 programi "Fuqizuar nga Kujdesi" ("Powered by Care") u përqendrua në:

Drejtimi dhe angazhimi

Gjatë vitit 2023 menaxhimi në të gjitha strukturat e Statkraft është angazhuar në mënyrë aktive dhe ka marrë pjesë në aktivitete lokale në programin Fuqizuar nga Kujdesi. Janë realizuar seminare për të adresuar lidhësin dhe kulturën në çështjet e shëndetit dhe sigurisë në nivele të ndryshme të organizatës. Një kartë e dedikuar "Ndaloni punën e pasigurt" është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Statkraft e cila është shpërndarë, duke i dhënë kujto që punon për Statkraft autoritetin për të ndaluar aktivitete të punës që i vlerësojnë të pasigurta.

Zbutja e lëndimeve serioze

Incidentet serioze (ato që janë, apo kanë potencialin të kenë pasoja serioze) analizohen për të identifikuar masa për parandalimin e përsëritjes, dhe mësimet e nxjerra ndahen me të gjithë organizatën. Përdorimi i Rregullave të Shpëtimit të Jetës me të cilat synohet parandalimi i lëndimeve serioze dhe fatale vazhdon mbetet një fushë me fokus të lartë, përveç përmirësimit të cilësisë së investigimeve dhe nxjerrjes së mësimet.

Trajnime

Trajnime dhe module e-learning janë të disponueshme për arritjen e grupeve specifike në ofrimin e trajnimit sipas nevojave të grupeve të ndryshme. Kjo përfshin një modul lidhur me "Powered by Care" që ofron trajnim bazë për të gjitha modulet e Rregullave të Ruajtjes së Jetës.

Treguesit Kryesorë të Ecurisë së angazhimeve

Janë vendosur tregues për të inkurajuar dhe matur angazhimin e punonjësve dhe drejtuesve p.sh. vëzhgimet e rrezikut, propozimet e përmirësimit, vëzhgimet pozitive dhe dialogët mbi sigurinë në punë. Këto Tregues Kryesorë të Ecurisë kanë pasur një zhvillim pozitiv prej vendosjes së tyre në vitin 2016.

Shpërblimi i CEO-s për SHSMM

Një skemë shpërblimi është vendosur për të inkurajuar veprimtaritë që kontribuojnë në përmirësimin e ndërgjegjësimit rezultatet dhe angazhimit në organizatë në lidhje me SHSMM.

Përmirësimi i vazhdueshëm

Është realizuar një rivlerësim vjetor i drejtimit rreth performancës së Statkraft lidhur me aktivitetet e SHSMM dhe rekomandimet janë integruar në planet SHSMM. Bashkëpunimi realizohet ndërmjet fushave të biznesit për shkëmbimin dhe mësimin nga incidentet, programet e shëndetit dhe sigurisë dhe praktikata më të mira.

Shëndeti

Kemi iniciativa të dedikuara që fokusohen në shëndet dhe mirëqenie, që adresojnë sfidat e dala nga pandemia Covid-19. Këto përfshijnë organizim fleksibel të punës, survejime pulsi për të kontrolluar statusin, promovimin e burimeve dhe mjeteve lidhur me shëndetin mendor, një javë vetëdijesimi rreth shëndetit mendor dhe webinarë të ndryshëm me fokus në shëndetin mendor dhe fizik. Vizioni i ri për Shëndetin dhe Sigurinë ka përfshirë një seksion të posaçëm për sinjalizimin dhe alokimin e përgjegjësive, 'Vend pune i shëndetshëm pa dëmtime apo lëndime'

Siguria publike

Veprimtaritë e Statkraft kërkojnë ndërveprim të theksuar me palët e treta dhe mjedisin dhe ne jemi të fokusuar në mundësimin e sigurisë së tyre. Masat realizohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore, si edhe procedurat dhe planet e detajuara të Statkraft për mbrojtjen e jetës, mjedisit dhe pasurisë. Kjo aplikohet për të gjithë ciklin e jetës së aseteve tona, gjatë projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe nxjerrjes nga përdorimi.

Për të garantuar që asetet tona të mos përbëjnë rrezik për publikun, përdoren vlerësime të riskut bashkë me masat përkatëse mbrojtëse për zbutjen, si edhe verifikimin e efektivitetit të zbatimit të këtyre masave. Fushat me fokus kryesorë janë siguria e digave, rrjedhave ujore dhe aseteve tona elektrike.

Siguria dhe reagimi ndaj emergjencave

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Në mënyrë aktive të parandalojë dëmtimin e njerëzve dhe aktiveve përmes një përjasje sistematike.	Zbatimi i iniciativave ndihmëse të identifikuar	●
Komente mbi ecurinë <ul style="list-style-type: none"> DHP vazhdon zbatimin e rregulloreve për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e shtuar mbi sigurinë. Rritur fokus ndaj çështjeve të sigurisë, në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare. 		
Iniciativat kryesore <ul style="list-style-type: none"> Masat kryesore të planifikuara për 2023 janë zbatimi i vazhduar i rregulloreve të sigurisë kombëtare dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Shoqërisë për mbrojtje IT/kibernetike. Operacionalizimi i mësimave të marra nga menaxhimi i emergjencave nga Covid-19 dhe të tjera në konceptin e Reagimit ndaj Emergjencave Ka nisur një përpjeke tërësore për zhvillimin dhe harmonizimin e kuadrit të korporatës për sigurinë e personelit 		

Përjasja jonë

DHP ka një përjasje gjithëpërfshirëse dhe ndjek praktikata e mira ndërkombëtare për administrimin e sigurisë. Siguria i referohet aftësisë për të mbajtur njerëzit, operacionet, informacionet dhe sistemet të mbrojtura nga dëmtimet e qëllimshme. Çështjet e sigurisë adresohen përmes një përjasje të bazuar në rrezik. DHP ka një marrëdhënie të mirë me shoqëri si lokale ashtu edhe globale të mbrojtjes, dhe merr pjesë në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar një kuptim të përditësuar të rreziqeve të sigurisë. Siguria e informacionit ka një prioritet të lartë dhe DHP ndjek praktikata e mira ndërkombëtare për administrimin e sigurisë së informacionit.

Qëllimi është të ndërtojë dhe në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë një kulturë të fortë të sigurisë së informacionit që siguron konfidencialitet, integritet dhe disponueshmëri të informacionit të DHP. Përgjatë 2023, DHP ka përjetuar një trend pozitiv në ndërgjegjësimin ndaj sigurisë së informacionit.

Rreziqet kryesore

DHP vlerëson rreziqet e sigurisë duke analizuar kërcënimet, dobësitë dhe pasojat. Kryerja e vlerësimeve të rrezikut të sigurisë është një përgjegjësi e linjës, e mbështetur nga njësia për Mbrojtjen dhe Përgjigjen ndaj Emergjencave dhe njësia për Sigurinë e Informacionit të Korporatës. DHP përdor një gamë të gjerë masash për të reduktuar rreziqet e sigurisë. Ndryshime të papitura në situata sigurie aktivizojnë masa të menjëhershme.

Përgatitja për emergjencë

Aftësia e DHP për të përballuar ngjarje emergjente të padëshiruara dhe serioze është një prioritet i vazhdueshëm. Një kërkesë e grupit mbi Administrimin e Përgjigjes ndaj Emergjencave u prezantua në 2017, për të siguruar një përjasje të përbashkët në përgjigjen ndaj emergjencave në të gjithë shoqërinë. Përgjigja ndaj emergjencave e DHP-së është e bazuar në përdorimin e skuadrave specifike të përkohshme. Kjo përjasje synon t'i mundësojë DHP-së të përballojë emergjencën në nivele lokale dhe strategjike.

DHP po punon gjithashtu me shoqëri të tjera, organizata jo-qeveritare, institucionet lokale të zbatimit të ligjit dhe departamentet e zjarfikëseve për të siguruar përgatitjen më të mirë të mundshme për të përballuar emergjencat.

Të drejtat e njeriut

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Garantojmë standarde të larta etike dhe respekt për të drejtat e njeriut në të gjitha aktivitetet e biznesit	Zero raste të konfirmuara ku të shkaktojmë, kontribuojmë apo të jemi të lidhur direkt me shkelje të të drejtave të njeriut sipas Parimeve Udhëzuese të KB për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut	●
Komentet mbi ecurinë		
<ul style="list-style-type: none"> • Arritjet kryesore në 2023 përfshijnë fokusin e shtuar në të drejtat e njeriut në proceset kryesore. 		
Iniciativat kryesore		
<ul style="list-style-type: none"> • Përditësimi dhe përmirësimi i vazhduar i kërkesave për të drejtat e njeriut, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare dhe integrimi në procese kryesore. • Trajnime ndërgjegjësimi për të drejta themelore të njeriut për skuadra të zgjedhura të DHP 		

Përjasja jonë

DHP, si pjesë e grupit Statkraft, është e angazhuar për të respektuar të drejtat e njeriut në të gjitha aspektet e operacioneve tona dhe në marrëdhëniet me partnerët tanë të biznesit. Kjo është e shprehur qartë në Kodin e Sjelljes së Statkraft, i miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Statkraft, si edhe në deklaratën e angazhimeve për të Drejtat e Njeriut e pranuar nga Menaxhimi i Korporatës së Statkraft. Të Drejtat e njeriut janë një nga tre fushat kryesore të fokusit në strategjinë e qëndrueshmërisë, së bashku me klimën dhe biodiversitetin.

Rreziqet kryesore

Vlerësimi i përditësuar i ndikimeve në të drejtat e njeriut nga Statkraft ka identifikuar katër fusha prioritare dhe rreziqet më të larta. Fushat ku duhet të përqendrojmë përpjekjet tona rreth të drejtave të njeriut janë:

- Marrëdhëniet me komunitetin dhe licenca sociale
- Shëndeti, sigurimi teknik dhe siguria, përfshirë privatësinë
- Kushtet e punës në ambientin e punës (brenda Statkraft)
- Punë e denjë në zinxhirin e furnizimit

Statusi në 2023

Gjatë vitit 2023 u realizua një ushtrim i reagimit ndaj emergjencave në shkallë të plotë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe strukturat e reagimit ndaj emergjencave në Bashkitë Gramsh dhe Maliq. Ushtrimi u realizua në hidrocentralin e Moglicës dhe përfshiu më shumë se 40 persona nga të gjitha palët pjesëmarrëse. Ushtrimi u vëzhgua dhe dokumentua në të gjithë tërësinë e tij. Gjatë tij u ushtruan procedurat e komunikimit, koordinimi i përgjegjësive dhe shërbimet e reagimit ndaj emergjencave. Mësimet e nxjerra gjatë ushtrimit do ndihmojnë në përmirësimin e përgatitjes ndaj emergjencave dhe për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me situata të emergjencave në centralet tona.

Për të siguruar ndërgjegjësim të lartë dhe për të shmangur rrezikun e sjelljes, grupi Statkraft ndërmer rregullisht seminare për ndërgjegjësimin dhe trajnime të lidhur me dilemat në sigurinë e informacionit për të gjitha fushat e biznesit dhe shtetet, përfshirë Shqipërinë.

Statusi në 2023

Iniciativat për të drejtat e njeriut

Në vitin 2023, ne vazhduam të përforcojmë angazhimin tonë në respekt të së drejtave të njeriut në procese kryesore dhe kemi vijuar me prioritet përpjekjet tona lidhur me çështje themelore të të drejtave të njeriut.

Konsultimet

Në 2023, kanë vazhduar konsultimet dhe angazhimet me një gamë të gjerë grupesh interesi lokale dhe qendrore.

Për hidrocentralet të Banjës dhe Moglicës, vazhdojnë të zbatohen marrëveshjet mbi masat lehtësuese dhe kompensimin shtesë edhe pas përfundimit të fazës së ndërtimit.

Shoqëria mban një komunikim të rregullt me përfaqësuesit e komunitetit për projektet e saj dhe operon me Mekanizmin e Shqyrtimit të Ankesave për të adresuar ankesat / pakënaqësitë.

Shkëmbimi i njohurive

Për secilin fazë përkatëse të zhvillimit të projektit janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi mbi veprimtaritë e projekteve (p.sh. shfrytëzimi i HEC-eve të Banjës dhe Moglicës).

Praktikat e punës

Iniciativat kryesore

- Vazhduar zbatimin e zhvillimit të njerëzve duke përfshirë aktivitetet e synuara për zhvillimin e udhëheqjes.
- Trajnim mbi paragjykimin e pavetëdijshëm për të gjithë liderët e Statkraft dhe forcimi i mekanizmave për të shmangur paragjykimet dhe anësitë në proceset e njerëzve të Statkraft.
- Aktivitetet kryesore të planifikuara për 2023 përfshijnë të punuarit në mënyrë aktive për të rritur numrin e femrave në pozicione drejtuese.
- Praktika të punës së sigurt nga shtëpia, përfshirë modelin e punës hibride
- Realizuar ndërgjegjësim rreth diversitetit dhe përfshirjes si edhe iniciativa për rritjen e kompetencave
- Ndjekje e indeksit të përfshirjes që mat përvojat e përfshirjes së punonjësve në mjedisin e punës

Përqasja jonë

Statkraft është e angazhuar të ketë një përvojë të mirë dhe përfshirëse të punonjësve, ku njerëzit mund të rriten dhe të fuqizohen për të bërë ndryshim. Ne besojmë se kushdo që punon për Statkraft luan një rol kyç në përmbushjen e vizionit tonë “Rinovojmë energjinë që fuqizon botën”

Në Statkraft, të gjithë punonjësit kanë një rol të rëndësishëm në arritjen e ambicies tonë për të udhëhequr tranzicionin drejt energjive të rinovueshme. Statkraft është e angazhuar për një mjedis pune të karakterizuar nga barazia, diversiteti dhe respekti i ndërsjellët.

DHP mbështet dhe respekton të drejtat e punës të njohura ndërkombëtarisht duke përfshirë lirinë e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës së negociimit kolektiv, eliminimi i të gjitha formave të punës së detyruar, ndalimin efektiv të punës së fëmijëve, dhe eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin. DHP gjithashtu punon për realizimin e këtyre të drejtave si pjese e administrimit të zinxhirit tonë të furnizimit.

Rreziqet kryesore

Është me rëndësi të veçantë për DHP të tërheqë, zhvillojë, dhe të mbajë njerëzit dhe kompetencën për të arritur qëllimin dhe strategjinë tonë.

Si gjatë vitit 2023 e në vazhdimësi për Statkraft është kritike të tërheqë, zhvillojë, dhe të mbajë forcën punëtore të nevojshme për të arritur qëllimin dhe strategjinë tonë për të udhëhequr tranzicionin drejt energjive të rinovueshme.

Statusi në 2023

Nëpërmjet sondazheve Pulse, punonjësit e DHP-së japin rregullisht informacion dhe ndikojnë në mënyrën se si DHP mund të përmbushë angazhimet e saj dhe të ketë përvojë të mirë dhe përfshirëse të punonjësve. Sondazhet Pulse janë realizuar në tremujorin e dytë dhe të katërt të vitit 2023, me një nivel pjesëmarrje prej 100%. Sondazhi i tremujorit të katërt tregoi një indeks të përgjithshëm të angazhimit në nivelin 8.2, që ishte i njëjtë me nivelin e sektorit.

Zhvillimi i njerëzve

Në 2023, ne kemi vijuar me zbatimin e masave për të mbajtur një nivel të lartë të angazhimit të punonjësit dhe të forcojmë më tej zhvillimin e njerëzve. Shembuj të kësaj përfshijnë përpjekje të vazhdueshme për të forcuar kompetencën e drejtuesve për të motivuar, zhvilluar dhe rritur ecurinë e skuadrave të tyre. Gjatë vitit 2023 u prezantuan disa iniciativa të ndryshme të zhvillimit të udhëheqjes, të projektuara për grupe dhe objektiva mësimi të ndryshme. Përpjekje të mëtejshme për të ndërtuar dhe zgjeruar zhvillimin e drejtimit do të vazhdojnë në 2023.

Përveç iniciativave të synuara për drejtuesit, DHP gjithashtu ka një fokus të vazhdueshëm në aktivitete mësimore të cilat janë të krijuara për nevojat e zhvillimit të punonjësve në të gjithë Shoqërinë. Statkraft ofron shume kurse të brendshme, mësim në internet dhe seminare. Në 2023, Statkraft vazhdoi të mësojë nga programet eksperimentale mbi metodat e shpejta të projekteve dhe të zhvillojë trajnime si një ofertë për të gjithë punonjësit.

Iniciativa për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive dhe kompetencave të reja do të prioritarizohen në vitin 2024.

Diversiteti i fuqisë punëtore dhe përfshirja

DHP kërkon të rrisë diversitetin dhe të nxisë përfshirjen. Ne besojmë se kjo mundëson perspektiva të reja dhe ide që nxisin inovacionin i cili përputhet me nevojat e klientëve tanë dhe shoqërisë. Angazhimi në diversitet dhe përfshirje është i lidhur me të gjitha fushat e diversitetit si p.sh. gjinia, kombësia, prejardhja arsimore, moshë dhe mendësitë. Ne kemi një angazhim të qartë për trajtimin e barabartë dhe toleranca zero për diskriminimin, bullizmin dhe ngacmimin janë parimet themelore të politikave të njerëzve të grupit Statkraft.

Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë masat e diversitetit dhe përfshirjes dhe tërheqja dhe zhvillimi i një force punëtore me diversitet dhe shumë kompetente do të vazhdojë të jetë prioritet i rëndësishëm në vitin 2024.

Në fund të vitit 2023, DHP kishte përafërsisht 40 punonjës. DHP kishte punonjës që përfaqësonin 3 kombësi të ndryshme. Përqindja e femrave në DHP ishte 35%.

Etika e biznesit

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Të parandalojë korrupsionin dhe sjelljet jo etike në të gjitha veprimtaritë	Zero incidente serioze të pajtueshmërisë Zbatim në kohë i masave të pajtueshmërisë	● ●
Komente mbi ecurinë <ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i programit të pajtueshmërisë vijon, duke përfshirë zbatimin e masave të planifikuara të lidhura me trajnimin, formimin e kulturës dhe lehtësimin e rreziqeve në procese kritike të biznesit. Arritje kryesore në 2023 përfshijnë realizimin e vlerësimit të thelluar të rrezikut për të gjithë grupin rreth Etikës në Biznes dhe Përputhshmërisë të realizuar në të gjitha vendet, kryerjen e një raundi të ri të mësimi nëpërmjet internetit dhe një fushatë për ndërgjegjësimin rreth mashtrimit. 		
Iniciativat kryesore <ul style="list-style-type: none"> Komunikimi i rregullt dhe veprimtari për formimin e kulturës, dhe trajnime të caktuara për të gjithë punonjësit mbi etikën në biznes, nëpërmjet moduleve interaktive e-Learning dhe trajnimeve me pjesëmarrje fizike. Rishikimi i rregullt i kontrolleve të brendshme në procese kyçe të biznesit për të siguruar përbalimin në mënyrën e duhur të rreziqeve të etikës në biznes. Zbatim i programit të pajtueshmërisë. Përforsim i burimeve të përputhshmërisë në të gjitha nivelet. 		

Përfaqja jonë

DHP, si pjesë e grupit Statkraft, është e angazhuar për standarde të larta të sjelljes në biznes. Kodi i Sjelljes i grupit Statkraft përcakton pritimërinë nga secili punonjës, dhe kërkesat tona strikte janë në një linjë me praktikën e mira ndërkombëtare. Etika e biznesit është një përgjegjësi në të gjitha nivelet, e mbështetur nga një funksion qendror i pajtueshmërisë. Ne kemi në aplikim një program gjithëpërfshirës të pajtueshmërisë i cili mbulon fushat e korrupsionit, mashtrimit, pastrimit të parave, sanksioneve dhe kontrollit të eksportit, si edhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit të konkurrencës. Programi mbulon të gjitha aspektet e programit të përputhshmërisë, dhe përfshin orientimin rreth rëndësisë nga menaxhimi, angazhimin e politikë bërjes dhe drejtimin së bashku me kontrollin e integritetit, mënyrën se si zbatohen kërkesat në procedura dhe kontrolle, të tilla si deklarimi i konfliktit të interesit, dhe zbatohet me anë të trajnimeve të vazhdueshme, komunikimit, raportimit dhe monitorimit. Përshtatshmëria dhe cilësia e aktiviteteve janë në rivlerësim të vazhdueshëm dhe përditësohen të paktën një herë në vit nga njësia e përputhshmërisë së korporatës, e cila mbështet dhe këshillon menaxhimin e Statkraft rreth programit të përputhshmërisë.

Rreziqet kryesore

Statkraft kryen rregullisht vlerësime të rrezikut kundër korrupsionit për të gjithë Grupin dhe një herë në vit për të gjitha fushat e biznesit. Procesi i administrimit të rrezikut është më i zgjeruar për vendet dhe projektet me rrezik më të lartë, dhe gjithmonë përfshin një kombinim të ekspertizës lokale dhe burimeve qendrore të pajtueshmërisë. Metodologjia për vlerësimin e rrezikut rishikohet rregullisht.

Rreziqet kryesore të korrupsionit lidhen me proceset e transaksioneve, prokurimeve dhe pagesave, përdorimi i agjentëve dhe ndërmjetësve, proceset e lejeve nga qeveria,

dhe administrimi i grupeve vendore të interesit. Rreziqet veçanërisht varen nga teknologjia dhe lloji specifik i biznesit. Këto ngjyime reflektohen në hartat e rreziqeve në njësi të ndryshme të biznesit.

Statusi 2023

Trajnimi dhe komunikimi

DHP sigurohet që të gjithë punonjësit të jenë të mësuar me parimet e përcaktuara nga Kodi i Sjelljes dhe rregullat e brendshme të etikës në biznes. Sesione trajnimi janë zhvilluar gjatë 2023, ndërsa të gjithë punonjësit e rinj përfunduan kurset virtuale. Gjatë vitit çështje të etikës në biznes janë përfshirë në udhëheqje dhe eventet e Grupit.

Portali i brendshëm i Statkraft për Etikën në Biznes është një nyje kyç për shkëmbimin e njohurive, angazhimin dhe ndërtimin e kulturës. Portali, i cili përmban materiale dhe udhëzues në të gjitha temat e rëndësishme është përditësuar gjatë vitit 2021 për një përvojë më të mirë përdorimi. Vendosim edhe objektiva rreth frekuencës së diskutimeve të dilemave që organizohen nga menaxherët në nivele të ndryshme, si edhe iniciativa të tjera të ngjashme. Ecuria ndaj këtyre objektivave monitorohet.

Kontrulli i partnerëve të biznesit

DHP si pjesë e grupit Statkraft ka procedura të qarta, të detajuara për përbalimin e rreziqeve të lidhura me palët e treta. Kjo përfshin një politikë për kontrollin e prejardhjes, klauzolat në kontrata dhe monitorimin e kryer për kontratat me rrezik të lartë. Të gjithë partnerët e biznesit me rrezik të lartë (duke përfshirë të gjithë agjentët) kontrollohen nga Njësia e Pajtueshmërisë. Rishikimet e kryera të integritetit përfshijnë vlerësim të strukturës së pronësisë (duke përfshirë pronarët përfitues), të lidhjeve me persona të ekspozuar politikisht dhe rreziqet e reputacionit të lidhura me palët e tjera. Është punuar më tej për kombinimin e kërkesave të vlerësimit të integritetit në procesin dhe sistemin e prokurimit dhe trajnime.

Parandalimi i mashtrimit dhe kontrollet e brendshme

Statkraft ka një fokus të veçantë në parandalimin e mashtrimit në proceset e prokurimit, kontabilitetit, tatimeve dhe thesarit. Gjatë vitit 2023 Statkraft ka vlerësuar rreziqet për mashtrimin dhe të vendosë masa zbutëse në procese shtesë, si procesi i të ardhurave dhe në sistemet IT. Në vijim është vendosur fokus në disa procese dhe fusha, të përzgjedhura nga një përfaqëse të bazë të rrezikut për grupin.

Në 2023 u ndërmorën disa nisma për të forcuar më tej procedurat dhe kontrollet e brendshme të lidhura me pajtueshmërinë. Pati zhvillime të mëtejshme në Sistemin e Parandalimit të Mashtrimit, duke përfshirë rregullime në kontrollet ekzistuese të proceseve financiare. Janë kryer projekte në mbarë korporatën me fokus në parandalimin e mashtrimit dhe kontrolle të përforuara do të realizohen gjatë vitit 2023 në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të mjetit të Analizës Financiare dhe të Mashtrimit.

Mbrojtja e të dhënave personale

Gjatë vitit 2023, Statkraft ka realizuar iniciativat e ndryshme për të përforcuar më tej programin tonë të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale:

- Ka vazhduar bashkëpunimi me Sigurinë IT për të siguruar që të gjitha iniciativat e reja në Statkraft që përpunojnë të dhënat personale të vlerësohen nga perspektiva e privatësisë në një kohë të arsyeshme
- Kemi marrë pjesë në disa aktivitete bashkëpunuese me Stafin e tjera të Korporatës për rritjen e vetëdijesimit rreth mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë
- Është përmirësuar disponibiliteti i udhëzimeve dhe modeleve në mënyrë që departamenti i Privatësisë së Korporatës të përmbushë detyrimet kur vlerësohet baza ligjore dhe angazhimi më palë të treta përpunuese, p.sh. garantimi i një përfaqëse konsistente për mënyrën se si angazhohemi me grupet e interesit

Trajtimi i shqetësimeve të raportuara

DHP ka praktika dhe procedura që lidhen me sinjalizimin. Sinjalizimi mund të bëhet me shkrim ose verbalisht, përmes çdo mënyre komunikimi. Këto procedura janë në përputhje me The Statkraft Way dhe Ligjin nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve", i ndryshuar.

Raportimet mund të bëhen përmes kanaleve të ndryshme të tilla si postë elektronike, telefon, ose përmes një kanali të dedikuar sinjalizimi i cili ka të instaluar një funksion që mbron anonimatën e raportuesit. Kanali i sinjalizimit është gjithashtu në dispozicion për përdoruesit e jashtëm përmes faqes së internetit të Statkraft (www.statkraft.com / www.statkraft.al).

Shqetësimet e raportuara vlerësohen bazuar në vlerësimin e natyrës dhe ashpërsisë së rastit dhe ndiqen sipas procedurave të vendosura. Disa shqetësime të raportuara janë mbyllur pas një vlerësimi fillestar nga Kontrolli i Shoqërisë, ndërsa disa janë ndjekur më tutje nga drejtimi i sektorit dhe/ose Kontrolli i Shoqërisë. Në disa raste, është vlerësuar e nevojshme të kryhet një hetim i brendshëm për të qartësuar faktet dhe për të ndërmarrë veprime të mundshme. Kontrolli i Shoqërisë është përgjegjës për të kryer këto hetime në mënyrë efikase, objektivist dhe në përputhje me procedurat e brendshme.

Shqetësimet e raportuara njihen brenda 72 orësh. Njësia fillon me realizimin e një kontrolli të cilësisë dhe shqyrtim paraprak të informacionit të marrë. Më tej, vlerësohet natyra e shqetësimeve dhe përcaktohen hapat e nevojshme për identifikimin e fakteve përkatëse. Kjo njësi është përgjegjëse për kryerjen e të gjitha hetimeve të brendshme.

Të gjitha shqetësimet e raportuara merren në konsideratë me seriozitet, dhe trajtimi i tyre bazohet në parimet e trajtimit të drejtë dhe objektiv, mbrojtjen e raportuesit, mbrojtjen e personave që janë subjekt i raportimit, konfidencialitetit, mbrojtja dhe siguria e të dhënave personale dhe proporcionalitet në procesin administrativ.

DHP ka në funksion Zyrën e Informacionit Publik për të mundësuar informacion lidhur me veprimtaritë e saj si dhe ka në funksion një Mekanizëm të Shqyrtimit të Ankesave për të zgjidhur ankesat nga komunitetet / individët lokalë.

SI E MBËSHITESIM TRANZICIONIN E GJELBËR

Administrimi Social dhe Mjedisor

Programi për Menaxhimin Social dhe Mjedisor (MMS) përfshin të gjitha masat lehtësuese sociale dhe mjedisore për Projektin Hidroenergjetik të Devollit. Këto masa janë zbatuar gjatë fazës së zbatimit të projektit bazuar në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) të vitit 2013 dhe fazën e operimit në kuadrin e Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social për Operacionet (PMMS-O) dhe projekte të tjera specifike të integruar në kuadrin e aktiviteteve të MMS. Masat zbatohen brenda moduleve kryesore dhe në përputhje me programin kryesor të zbatimit të projekteve. MMS ndjek një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) të kryer për Projektin Hidroenergjetik të Devollit.

MMS është e përbërë nga tre komponentë kryesorë, Mjedisi, Ri-sistemimi dhe Zhvillimi Social dhe Marrëdhënie me Komunitetin. Programi zbatohet përmes PMMS & PMMS-O, i cili përshkruan angazhimet e DHP për mjedisin dhe familjet / personat e prekur nga projekti në lidhje me zbutjen e ndikimeve të projektit dhe promovimin e mundësive të zhvillimit të projektit në Luginën e Devollit. Ky plan është bërë publik që nga tetori 2013 dhe është i aksesueshëm përmes faqes së internetit të DHP dhe Zyrës së Informimit të Publikut të DHP në hidrocentralin e Banjës.

Programi MMS i DHP-së synon të jetë në përputhje me Standardet e Performancës mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC). Qëllimi është të sigurohemi që programet MMS të zbatohen në atë mënyrë që të gjitha familjet e prekura nga projekti dhe komunitetet të kenë rifituar ose mundësisht përmirësuar standardet e jetesës si rezultat i projektit dhe si pasojë të bëhen përfitues të projektit.

Qëllimet e MMS:

- Të identifikojë dhe zbusë ndikimet e mjedisore dhe sociale të projektit dhe të nxisë mundësi të qëndrueshme zhvillimi
- Të ndihmojë njerëzit e zhvendosur për të përmirësuar jetesën dhe standardet e tyre të jetesës ose të paktën për t'i rikthyer ato në nivelet para-projektit
- Të marrë masa për zbutjen e ndikimit në mjedis për të minimizuar ndikimet e projektit në mjedisin natyror dhe të zhvillojë shërbime të infrastrukturës mjedisore për të shmangur efektet negative si për projektin ashtu edhe për grupet kryesore të interesit

Biodiversiteti

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Ofrimi i energjisë miqësore ndaj klimës, të rinovueshme dhe marrja e masave të përgjegjshme mjedisore	Zero incidente serioze mjedisore mbi biodiversitetin	●
Komentet mbi ecurinë <ul style="list-style-type: none"> • DHP nuk kishte incidente serioze mjedisore në vitin 2023. Shoqëria ndërmori një gamë të gjerë iniciativash, të kërkuara nga autoritetet e energjisë ose mjedisit ose vullnetarisht, që synonin ruajtjen e biodiversitetit. • Arritje kryesore në zbatimin e masave zbutëse mjedisore gjatë vitit 2023 në zonat e HEC-ve të Banjës dhe Moglicës, siç është pyllëzimi i një sipërfaqe të konsiderueshme. Gjithashtu, monitorimi i treguesve mjedisorë duke u përqendruar në cilësinë e ujit të lumit Devoll dhe rezervuarëve të Banjës dhe Moglicës. 		
Iniciativat kryesore <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e zgjeruar dhe komunikimi i ecurisë së trajtimit sistematik të biodiversitetit, p.sh. monitorimi i ekologjisë ujore dhe dorëzimi i rezultateve tek autoritetet përkatëse, sipas kërkesës. • Rritja e të kuptuarit të ndikimeve tona në biodiversitet, dhe trajtimi adekuat në zhvillimin dhe funksionimin e projektit. • Masat kryesore të planifikuara për vitin 2023 janë monitorimi i cilësisë së ujit në lumin Devoll dhe rezervuarët e Banjës / Moglicës për monitorimin e zhvillimit dhe krahasimit me të dhënat bazë. • Vazhdimi i zbatimit të programit të pyllëzimit, përfshirë rehabilitimin përmes pyllëzimit të zonave të prekura nga projekti. • Ndarja e njohurive lidhur me programet mjedisore dhe sociale me palë të treta si universitete, apo shkolla. 		

Përqasja jonë

DHP është e angazhuar të administrojë në mënyrë të përgjegjshme ndikimet në biodiversitet, të shkaktuara nga aktivitetet e Shoqërisë dhe i kushton vëmendje të veçantë monitorimit të parametrave mjedisorë në cilësinë e ujit dhe biodiversitetin ujor. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i kushtohet zbatimit të një programi të gjerë pyllëzimi.

Rreziqet kryesore

Në nivel global, rreziku më i madh për biodiversitetin është copëtimi dhe degradimi i habitateve të gjallesave. Në një raport vlerësimi global të botuar në vitin 2019, "Platforma Ndërqeveritare e Shkencës-Politikës mbi Biodiversitetin dhe Shërbimet e Ekosistemit" e Kombeve të Bashkuara deklaroi se ky është për biodiversitetin një kërcënim më i madh sesa ndryshimi i klimës.

I gjithë gjenerimi i energjisë ndikon në biodiversitetin dhe mjedisin. Ndikimi i DHP në biodiversitet vjen nga aktivitetet tona kryesore të gjenerimit të hidroenergjisë. Hidroenergjia modifikon kushtet e jetesës së gjallesave ujore, gjë që paraqet një sfidë për peshqit mërgimtarë. Vlerësimi i rreziqeve mjedisore që lidhen me biodiversitetin është pjesë e procedurave dhe praktikave të administrimit të rrezikut të DHP dhe e integruar në PMMS / PMMS-O.

Statusi 2023

Programi i pyllëzimit

Në zonën e projektit janë zbatuar projekte të pyllëzimit në një sipërfaqe prej mbi 870 Ha me mbjelljen kryesisht të specieve pyjore apo frutore gjatë gjithë fazës së zbatimit të projekteve të pyllëzimit, të shtrirë në disa vite. Në më shumë se 95% e sipërfaqeve të pyllëzuara, Projektet e Pyllëzimit kanë përfunduar zbatimin e suksesshëm dhe u janë dorëzuar bashkive përkatëse. Në rreth 5% që mbetet vazhdon faza e mirëmbajtjes së pyllëzimeve deri në dorëzimin e tyre pranë autoriteteve përkatëse.

Cilësia e ujit dhe monitorimi i biodiversitetit ujor

Nuk janë identifikuar ndikime të konsiderueshme negative në mjedis.

Aksione për klimën

Iniciativat kryesore

- Ndjekja nga afër e politikave klimatike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Zhvillimi i vazhdueshëm i tregut të Statkraft dhe analiza strategjike në mënyrë që të merren vendime tregtare solide dhe të vlerësohet se si ndryshimet klimatike dhe politikat klimatike ndikojnë në portofolin dhe strategjinë e Statkraft.

Përqasja jonë

Ndryshimet klimatike përbëjnë një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballlet bota. Përmes bërthamës së veprimtarisë tonë të biznesit, DHP kontribuon në rritjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e rinovueshme. DHP është e përkushtuar për neutralitetin e klimës dhe është regjistruar në iniciativën Klimë Neutrale Tani e Kombeve të Bashkuara (UN Climate Neutral Now) si pjesë e grupit Statkraft. Kontributet kryesore të DHP në një sistem energjie më të qëndrueshëm janë operacionet tona aktuale dhe investimet e reja në energjinë e rinovueshme dhe aktivitetet e lidhura të tregut.

Rreziqet kryesore

Ndryshimet e modeleve të motit do të ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën e aktiveve të DHP, pasi do të ndikojnë në gjenerimin vjetor të centraleve dhe në vlerën e fleksibilitetit që mund të ofrojnë centralet. Hidrocentralet janë veçanërisht të ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike. Moti më ekstrem mund të sfidojë edhe integritetin fizik të infrastrukturës sonë. Ndërsa jeta e komponentëve të rëndësishëm si digat, rrugët ujore dhe turbinat është e gjatë, ndryshimet strukturore të motit duhet të konsiderohen si në investimet e fushës së gjelbër, ashtu edhe në përditësimet dhe përmirësimet. Nga ana tregtare, ndryshimet në nivelet e reshjeve do të ndikojnë në prodhimin e centraleve, dhe modelet më ekstreme të motit mund të rrisin vlerën e fleksibilitetit dhe kapacitetit të ruajtjes.

Statusi 2023

Energjia e rinovueshme

Në vitin 2025, Statkraft synon të mbetet prodhuesi më i madh në Europë i energjisë së rinovueshme dhe mes tre prodhuesëve të energjisë më të mëdhenj në Europë që janë në harmoni me mjedisin. Më tej, Statkraft synon objektiva në emetimet në nivel global: Intensiteti i karbonit (qëllimi 1+2) të jetë <50 g CO₂e/kWh brenda vitit 2025, dhe <35 g CO₂e/kWh deri në vitin 2030 e në vijim. Statkraft të jetë neutrale për karbonin (qëllimi 1+2) deri në 2040. Statkraft të jetë net-zero (qëllimi 1+2+3) deri në 2050.

Mbështetje për dekarbonizimin e shoqërisë

Në vitin 2023, analistët e Statkraft paraqitën një analizë tërësore të tregut global të energjisë drejt vitit 2050. Skenari i Emetimeve të Ulëta i Statkraft ofron skenar optimist në aspektin e teknologjisë, por edhe realist, të sistemit global të energjisë drejt vitit 2050. Në Skenarin e Emetimeve të Ulëta, kërkesa për energji do të rritet më shumë se dyfish dhe energjitë e rinovueshme do të ofrojnë mbi 80% të kërkesës globale për energji në vitin 2050. Brenda vitit 2050 energjia nga dielli dhe era priten të rriten me 21 dhe 11 herë përkatësisht. Në Evropë, edhe në skenarin më pak optimist, kapaciteti i energjive nga dielli dhe era rritet me rreth 250% nga nivelet aktuale drejt vitit 2050 dhe arrin një pjesë tregu prej 66% dhe emetimet reduktohen ndjeshëm. Në Skenarin e Emetimeve të Ulëta energjia e rinovueshme do të furnizojë 87% të kërkesës për energji në vitin 2050 dhe BE-ja do të arrijë ambicinet e saj net-zero. Skenari i Emetimeve të Ulëta i Statkraft ndodhet pak më ulët se përcaktimi prej 2°C. Ky është skenar ambicioz, por akoma i pamjaftueshëm. Përafrimi me objektivin më afër 1.5°C do të kërkonte bashkëpunim global dhe ndryshim rrënjësor në përshejtim në të gjithë sektorët.

Prodhimi i energjisë elektrike i DHP-së nga hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës është i certifikuar nga Enti Rregullator i Energjisë me Certifikatë e Garancisë së Origjinës, si energji elektrike nga burime të rinovueshme. DHP po përgatitet të marr pjesë në tregun rajonal të Garancive të Origjinës sapo ky treg të jetë operacional.

Ndryshimet klimatike dhe operacionet e tregut

Hidrocentralet e DHP kanë rezervuar të mëdha të cilët mund ta ruajnë ujin përgjatë stinëve dhe viteve. Një element kyç i procesit të administrimit të përditshëm të energjisë është parashikimi për prurjet e ardhshme dhe pasiguritë e lidhura me to. Këto vlerësime bazohen në vëzhgime historike gjatë disa dekadave. Seritë kohore sigurisht duhet të rregullohen në bazë të ndryshimeve klimatike për të siguruar një bazë të vlefshme për vlerësimin e prurjeve të ardhshme. Për DHP-në, të kuptosh se si klima po ndryshon është me rëndësi për veprimtaritë tona të përditshme.

Kuadri rregullator dhe potenciali për reduktimin e emetimeve

Politikat klimatike kanë një ndikim të madh tek DHP. Politikat klimatike dhe të energjisë janë gjithmonë e më shumë të ndërlidhura. DHP si pjesë e grupit Statkraft ndjek nga afër zhvillimet në politikat klimatike kombëtare, Evropiane dhe globale për të vlerësuar ndikimin e politikave të tilla. Të kuptuarit e zhvillimit të energjisë së rinovueshme dhe teknologjive të lidhura me të është gjithashtu e rëndësishme, për shkak se kjo ndikon në ritmin e transmetimit të energjisë dhe pozicionin tregtar të DHP-së. Për këtë arsye Statkraft investon burime të rëndësishme në analizën e tregjeve, për të pasur një bazë të fortë për vendimet e investimit dhe shfrytëzimit.

Administrimi i ujit

QËLLIMI	SYNIMI	STATUSI
Statkraft të njihet si një shoqëri me një praktikë të përgjegjshme në administrimin e ujit	Zbatimi i masave mbështetëse të identifikuara	●
Komente mbi ecurinë <ul style="list-style-type: none"> DHP optimizon përdorimin e ujit duke përmirësuar vazhdimisht performancën e saj mjedisore dhe ekonomike. Në kontekstin e ndryshimeve klimatike, përshtatja e kapacitetit mbajtës të ujit të rezervuarëve të hidrocentraleve kontribuon në reduktimin e përmbajtjeve dhe thatësirave në bazenet e lumenjve. Arritjet kryesore në 2023 përfshijnë aktivitete të përgjegjshme për çdo ditë, veçanërisht në situata ekstreme, ku synojmë kontribuojmë në reduktimin e ndikimeve të ngjarjeve të përmbajtjeve të mëdha në Shqipëri. Njohuritë dhe efica në administrimin e integruar të burimeve të ujit janë forcuar. 		
Iniciativa kryesore <ul style="list-style-type: none"> Të sigurojë menaxhim të përshtatshëm si dhe ndjekje sistematike të kërkesave të koncesionit lidhur me nivelet e ujit, limitet e prurjeve dhe rregullave specifike. Të demonstrojë administrim të përgjegjshëm të ujit bazuar në përmirësimin e të kuptuarit të efekteve të ndryshimit klimatik. Kjo përfshin planifikimin për situata potencialisht ekstreme si në vitet e lagësht ashtu edhe ata të thatë dhe të vazhdojmë të jemi në gjendje të përmbushim kërkesat e koncesionit. 		

Përqsja jonë

Menaxhimi i përgjegjshëm dhe optimal i burimeve ujore kërkon kapacitetin për analizimin e volumeve të mëdha të të dhënave, dhe parashikimin e kushteve të motit sa më saktësisht të jetë e mundur, për të krijuar vlerë për shoqërinë në mënyrë të qëndrueshme. Këto detyra komplekse kërkojnë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet ekspertëve të ndryshëm në hidrologji, meteorologji, analizë tregu dhe planifikim prodhimi. Aktivitetet tona mbulojnë katër fusha: rritjen e efica së përdorimit të burimeve, mbajtja e fleksibilitetit, menaxhim operativ i ujit dhe menaxhim i cilësisë së ujit.

Duke përdorur ujin për prodhim të energjisë së rinovueshme, DHP luan një rol të rëndësishëm në administrimin e këtij burimi të përbashkët. Administrimi i ujit është rregulluar nëpërmjet ligjeve dhe koncesioneve të cilat marrin në konsideratë nevojat sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Sistemi i menaxhimit i Statkraft do të sigurojë një qasje sistematike, të bazuar në riskun dhe të orientuar sipas objektivave për të garantuar përputhshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Rreziqet kryesore

Rreziqet kryesore që lidhen me ujin në Statkraft lidhen me menaxhimin e burimeve ujore me përgjegjësi në prodhimin e energjisë nga uji. Faktor kyç suksesi për menaxhim të përgjegjshëm të ujit është parashikimi i reshjeve me saktësinë sa më të lartë me qëllim të reduktimit të rrezikut të përmbajtjeve apo thatësirës, të optimizohet prodhimi i energjisë në përmbushje të rrjedhave minimale të përcaktuara.

Menaxhimi i burimeve ujore i lidhur me prodhimin e energjisë nga uji nuk është vetëm ndikim kyç në mjedis, por edhe risk kryesor në aktivitetet bazë të biznesit të Statkraft, pasi Statkraft varet në ndarjen e burimeve ujore me përdorues të tjerë dhe planifikimin e prodhimit të energjisë bazuar në modele gjithnjë e më të paparashikueshme të motit.

Statusi 2023

Menaxhimi i ujit dhe modelet e motit


Kur flitet për menaxhim të përgjegjshëm uji në sektorin e hidroenergjisë, është e rëndësishme të parashikohen reshjet me saktësi sa më të madhe.

Hidrologjia në ujëmbledhësin e Lumit Devoll ka qenë shumë sfiduese gjatë vitit 2023, me reduktim të konsiderueshëm të prurjeve ujore në rezervuarët tanë, krahasuar me historikun e prurjeve, çka ka rezultuar në ulje të qenësishme të sasisë së prodhimit të energjisë elektrike përgjatë vitit.

Aktualisht po zbatohet një program monitorimi mjedisor me fokus në monitorimin e cilësisë së ujit në Lumin Devoll dhe rezervuarët e Banjës dhe Moglicës, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Njohuritë e përmirësuara

Grupi Statkraft synon të jetë forcë udhëheqëse në Kërkimin & Zhvillimin në hidroenergj. Planifikimi më i mirë dhe mjetet për përmirësim të zhvilluara përmes projekteve të Kërkim & Zhvillimit i mundësojnë gjithmonë e më shumë Statkraft-it të përballojë më mirë ndryshimet afatgjata në ecurinë dhe kushtet ekstreme të motit.

An aerial photograph of a large dam and reservoir. The reservoir is a vibrant turquoise color, reflecting the sky and surrounding green mountains. The dam structure is visible in the lower foreground, with a road and some infrastructure. The background shows rolling hills and mountains under a clear blue sky.

**Energjia e rinovueshme
mund të fuqizojë çdo
industri, çdo biznes, çdo
komunitet, çdo shtëpi.
Mund të fuqizojë progresin.
Mund të fuqizojë
mundësitë.**



Raporti i
Drejtimit të
Brendshëm

2023

Bordi i Drejtorëve

Simen Braein

Drejtues i Bordit, nga nëntori 2022.

Michelle Funes

Anëtar i Bordit, nga nëntori 2022.

Qiong Chen

Anëtar i Bordit, nga nëntori 2022.

Drejtimi i Brendshëm

Kontrolli dhe drejtimi eficient dhe transparent i biznesit përbën bazën për krijimin e një vlere afatgjatë për pronarin, punonjësit, palët e tjera të interesuara dhe shoqërinë në përgjithësi, dhe si rezultat, kontribuon në krijimin e vlerave të qëndrueshme dhe të përhershme. Shpërndarja e roleve frymëzon besimin mes palëve të interesuara përmes parashikueshmërisë dhe besueshmërisë. Komunikimi i hapur dhe i arritshëm nga shoqëria siguron se Shoqëria mban një lidhje të mirë me shoqërinë në përgjithësi dhe me të gjithë palët e interesuara të ndikuara nga veprimtaritë e shoqërisë.

VEPRIMTARITË

Objekti i DHP, përmes bashkëpunimit me shoqëri të tjera të grupit, është të planifikojë, të projektojë, të ndërtojë dhe të shfrytëzojë objekte të energjisë, të kryejë tregtim fizik dhe financiar të energjisë, dhe të kryejë operacionet e lidhura. DHP është regjistruar në Shqipëri dhe struktura e saj e drejtimit është e bazuar në legjislacionin shqiptar për Shoqëritë. DHP është gjithashtu subjekti i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në lidhje me detyrimet e shoqërisë për licencimin.

KAPITALI

Kapitali aksionar i DHP është në vlerën e 86 890 000 mijë Lekë i ndarë mes 86 890 aksioneve me vlerë prej 1 000 000 Lekë secili. Aksionet e Shoqërisë zotërohen nga Statkraft Markets B.V., pjesë e grupit Statkraft. Primi i kapitalit aksionar të DHP është në vlerën e 9 690 mijë Lekë.

Rritjet e kapitalit kryhen përmes mbledhjeve të shoqërisë Statkraft Markets B.V.

Bordi i Drejtorëve fokusohet vazhdimisht në përshtatjen e objektivave të shoqërisë, strategjisë dhe profilit të rrezikut me situatën e kapitalit të shoqërisë. Investimet e DHP financohen përmes kapitalit të ri të investuar nga pronari.

TRAJTIMI I BARABARTË I AKSIONAREVE DHE TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

DHP hyn në transaksione me shoqëritë e grupit Statkraft. Të gjitha transaksionet janë të bazuara në kushte dhe parime të zakonshme tregtare.

Udhëzimet kundrejt Bordit të Drejtorëve përcaktojnë që as anëtarët e bordit as CEO nuk mund të marrin pjesë në diskutimin apo zgjidhjen e çështjeve që janë me interes thelbësor personal ose financiar për ata ose për palët e lidhura me ta. Çdo person në një situatë të tillë duhet, me iniciativën e tij, të informojë për çdo interes që ata ose palët e lidhura me ta mund të kenë në zgjidhjen e një çështjeje. E njëjta gjë përcaktohet edhe nga udhëzimet e etikës së Grupit.

BORDI I DREJTORËVE

Shoqëria drejtohet dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga 3 anëtarë, me mandat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve emërohen nga Aksionari i Vetëm, Statkraft Markets B.V.

Bordi i Drejtorëve zgjedh nga anëtarët një Kryetar i cili do të kryesojë dhe do të drejtojë diskutimet gjatë mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve. Mandati i Kryetarit të Bordit të Drejtorëve duhet të jetë 3 (tre) vite. Në rast të vendeve të lira të ndonjë prej anëtarëve, Bordi i Drejtorëve duhet të zëvendësojë vendin e mbetur të lirë me marrëveshje të miratuar nga Bordi i Drejtorëve, deri në Mbledhjen e Përgjithshëm të radhës të Aksionareve.

Bordi i Drejtorëve ka fuqinë të caktojë Drejtorin e Përgjithshëm (CEO).

Si pjesë e grupit Statkraft, DHP ndjek parimin "arm's length" (parimi i tregut) për transaksionet brenda grupit, në përputhje me udhëzimet e praktikës më të mirë, përveç rasteve kur ka dispozita të tjera ligjore për aplikimin e mekanizmave të tjerë të përcaktimit të çmimit.

QËLLIMI I BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve zakonisht mbledhet të paktën katër herë në vit. Kryetari i Bordit të Drejtorëve mund të kërkojë mbledhjen e bordit sa herë të jetë e nevojshme.

Bordi i Drejtorëve i jep udhëzimet Drejtorit të Përgjithshëm (CEO) në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë, monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të biznesit nga CEO, përshtat strategjitë, politikat, procedurat dhe rregulloret e brendshme për të mbikëqyrur dhe kontrolluar në bazë të vazhdueshme veprimtarinë, rekomandon vendimet që do të diskutohen nga Mbledhja e Përgjithshme dhe ekzekuton më pas vendimet e këtij të fundit, sigurohet që shoqëria zbaton ligjet në fuqi dhe standardet e kontabilitetit, shqyrton dhe kontrollon librat e Shoqërisë, dokumentet dhe aktivet etj.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtori i Përgjithshëm (CEO) administron veprimtarinë e përditshme të biznesit të Shoqërisë dhe përfaqëson atë në lidhje me palët e treta.

Drejtori i Përgjithshëm raporton në Bordin e Drejtorëve në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe në rast të përmbylljes së transaksioneve me rëndësi të veçantë për ecurinë e Shoqërisë.

AKSIONARI I VETËM

Aksionari i Vetëm përfaqëson 100% të kapitalit aksionar të Shoqërisë. Bordi i Drejtorëve ose Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të marrin asnjë vendim, pa miratimin paraprak të Aksionarit të Vetëm në lidhje me:

- (a) çështje lidhur me aksionet (ose titujve të konvertueshëm në aksione) të Shoqërisë;
- (b) ndryshime në Aktet e Themelimit të Shoqërisë;
- (c) shitje të plotë ose të një pjese të rëndësishme të biznesit të Shoqërisë;
- (d) ndryshime madhore në natyrën ose objektivin e biznesit të Shoqërisë;
- (e) emërimi (ose shkarkimi) i audituesve të Shoqërisë;
- (f) aplikimin e Shoqërisë për likuidim, falimentim apo riorganizim sipas ligjeve të likuidimit ose veprimeve të ngjashme;
- (g) Miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë;
- (h) Shpërndarjen e fitimeve vjetore të Shoqërisë; dhe
- (i) Çdo çështje tjetër që ka nevojë për miratimin paraprak të Aksionareve sipas detyrimeve të legjisllacionit shqiptar.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

Koncepti i kontrollit të brendshëm përfshin pajtueshmërinë me vlerat bazë të shoqërisë dhe me udhëzimet për etikën dhe përgjegjësinë e korporatës. Funksione të rëndësishme për të siguruar që administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm janë një pjesë e integruar e veprimtarisë së DHP përfshijnë auditimin e brendshëm të Grupit, funksionin e pajtueshmërisë, funksionin e rrezikut të Grupit, njësinë e Rishikimit të Investimeve të Grupit dhe kontrollin e brendshëm të Grupit në lidhje me raportimin financiar.

Administrimi i rrezikut është një pjesë përbërëse e të gjitha aktiviteteve në organizatë dhe në procesin e marrjes së vendimeve. Ai mbështet vendimmarrësit të vendosin prioritetet në veprimet e tyre. Drejtuesit në të gjitha nivelet e organizatës janë përgjegjës për administrimin e duhur të rrezikut. Administrimi i rrezikut është i rregulluar nga rregulla dhe udhëzues.

Ndjekja dhe administrimi i rrezikut janë të inkuorporuar në operacionet e përditshme të biznesit.

Administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm janë pjesë përbërëse e punës së Bordit të Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që CEO:

- ka përcaktuar instruksione dhe udhëzime të qarta se si do të vendosen në praktikë administrimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm nga Shoqëria
- ka ngritur procese dhe funksione të përshtatshme për kontroll
- është siguruar që administrimi i rrezikut dhe kontrollit të brendshëm është kryer, dokumentuar, monitoruar dhe ndjekur në mënyrë të kujdesshme

Sistemi i menaxhimit të grupit Statkraft, "The Statkraft Way" (Metoda e Statkraft), përcakton parimet kryesore të grupit dhe siguron një mjedis të shëndetshëm kontrolli për të përmbushur qëllimet dhe synimet e drejtimit. Metoda e Statkraft është e bazuar në parimet ISO për cilësinë dhe sistemet e administrimit mjedisor.

Modeli i drejtimit të DHP ka një përfaqje të bazuar në rrezik në vendosjen e qëllimeve, prioritetëve dhe ndjekjen e biznesit dhe çështjeve të stafit. Funksioni i rrezikut i Grupit është përgjegjës për kuadrin e përgjithshëm të administrimit të rrezikut dhe monitoron rreziqet e përgjithshme në nivel Grupi.

Auditimi i shoqërisë

Funksioni i Grupit për auditimin e shoqërisë është një funksion i pavarur i cili ndihmon Bordin lokal të Drejtorëve dhe drejtimin lokal në vlerësimin nëse rreziqet kryesore administrohen dhe kontrollohen mjaftueshëm. Qëllimi i Auditimit të Shoqërisë është të zgjerojë dhe të mbrojë vlerat organizative duke mundësuar siguri objektive dhe të mbështetur në vlerësimin e rreziqeve, këshillim, dhe informacion lidhur me drejtimin e organizatës, administrimin e rrezikut dhe kontrollin e brendshëm.

Auditimet e brendshme të grupit janë kryer në përputhje me planin vjetor të veprimit. Puna e auditimit duhet të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (International Standards for Internal Auditing - IIA).

Menaxheri i Pajtueshmërisë së DHP është përgjegjës për sistemin e raportimit të pavarur të problemeve të lidhura me çështje jo-etike apo të paligjshme. Në rastet kur është i nevojshëm ndonjë hetim, kjo është përgjegjësi e Kreut të Grupit për Auditimin e Korporatës.

Kontrolli i brendshëm i raportimit financiar


CFO i Grupit është përgjegjës për procesin e Kontrollit të Brendshëm të Raportimit Financiar (Internal Control in the Financial Reporting - ICFR) në DHP. Puna e ICFR është e bazuar në kuadrin e COSO për kontroll të brendshëm, të publikuar nga Komiteti i Organizatave Sponsorizuese (Committee of Sponsoring Organizations) i Komisionit Treadway.

ICFR siguron informacion financiar të besueshëm dhe në kohë gjatë periudhës dhe në RAPORTET E ECURISË DHE DREJTIMIT TË BRENDSHËM. DHP duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e ICFR.

Veprimtaritë e lidhura me ICFR kryhen nga sistemi i Drejtimit, Rrezikut dhe Pajtueshmërisë (DRP) së Grupit, BWISE. Përmes BWISE, Grupi mund të monitorojë në mënyrë efektive dhe në kohë reale statusin e kontrollit të ecurisë përgjatë gjithë organizatës.

Procesi vjetor për kontrollin e brendshëm të raportimit financiar

Annual process for internal control over financial reporting



Elementët kryesorë të sistemeve ICFR janë:

- **Vlerësimi i rrezikut**

Rrjeti i ICFR të Grupit kryen vlerësime vjetore ku identifikohen dhe vlerësohen rreziqet e raportimit financiar. Qëllimi është të verifikohet nëse shoqëritë e grupit Statkraft kanë kontrollin e duhura për të ulur mjaftueshëm këto rreziqe.

- **Vlerësimi i hartimit të kontrollit**

Proces për të garantuar se kontrollin e brendshme janë hartuar në mënyrë eficiente dhe zbusin rreziqet e identifikuar në një nivel të pranueshëm.

- **Testi i ecurisë së kontrollit**

Çdo tremujor dhe me bazë kampionesh/mostrash, testohen cilësia e ecurisë së kontrollit dhe pajtueshmëria me përshkrimet e kontrollit për të siguruar efektivitetin operacional dhe përmirësim të vazhdueshëm.

- **Raportimi i ICFR tek Komiteti i Auditimit**

Si pjesë e raportimit tremujor, statusi rreth kontrollit të brendshëm i paraqitet Komitetit të Auditimit. Më tej, rezultati i vlerësimit vjetor i lidhur me hartimin e kontrollit dhe efektivitetin operacional raportohet tek Komiteti i Auditimit në tremujorin e parë. Konkluzioni i vlerësimit të rrezikut të raportimit financiar raportohet në tremujorin e dytë. Nëse zbulohen shkelje materiale në ICFR do të raportohen në Komitetin e Auditimit.

- **Ecuria e vazhdueshme dhe monitorimi**

Menaxherët janë përgjegjës për pajtueshmërinë me përshkrimin e kontrollit dhe kërkesat e ICFR. Menaxherët përgjegjës realizojnë një vlerësim vjetor të kontrollit dhe efektivitetin operacional të të gjithë kontrolleve.

Sistemi i parandalimit të mashtrimit

DHP si pjesë e grupit Statkraft ka një sistem për parandalimin e mashtrimit për të shmangur dhe sinjalizuar mashtrimin në procese të lidhura me prokurimin, kontabilitetin, tatimet dhe thesarin. Sistemi i parandalimit të mashtrimit është në zhvillim të vazhdueshëm. Sistemi ka një përjasje të bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe përdor metodologjinë e vendosur për sistemin ICFR.

INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Duke filluar nga viti 2020, DHP publikon pasqyrat e saj financiare vjetore dhe RAPORTIN E ECURISË SË VEPRIMTARISË DHE TË DREJTIMIT TË BRENDSHËM në faqen e internetit të DHP-së. Çdo vit, DHP dorëzon këto dokumente në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.


DHP i kushton rëndësi komunikimit transparent me të gjitha palët e interesuara. Informacioni që shoqëria i siguron aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara duhet të sigurojë mjaftueshëm detaje për të lejuar vlerësimin e vlerave të shoqërisë dhe ekspozimin ndaj rrezikut.

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë dhe Drejtimit të Brendshëm është përgatitur gjithashtu në përputhje me nenet nr. 17 dhe nr. 19 të Ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare nr. 25/2018, date 10.05.2018. Raporti është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë.

AUDITUESI

Aksionari emëron audituesin bazuar në propozimin e Bordit të Drejtorëve. Audituesi shërben deri në momentin që emërohet një auditues i ri.

Bordi i Drejtorëve dhe audituesi mbajnë të paktën një takim vjetor ku CEO dhe drejtues të tjerë të Shoqërisë nuk janë të pranishëm. Bordi i Drejtorëve njihet shkurt me pikat më të rëndësishme të raportit të audituesit.



Energjia e rinovueshme është e qëndrueshme dhe me përfitim. Aktivitetet e DHP provojnë që një botë me energji plotësisht të pastër mund të ndodhë sot jo vetëm sepse është e drejtë, por sepse është biznes më i mirë.



Treguesit Kryesorë
dhe Matësit Alternativë
të Ecurisë

2023

Treguesit Kryesorë

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË

	Njësia	2023	2022
Pasqyra e fitimit ose humbjes			
Të ardhurat bruto nga aktivitetet e shfrytëzimit	mijë Lek	16 510 581	20 498 364
Të ardhura neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	mijë Lek	12 144 416	14 514 031
Kthim i humbjes nga zhvlerësimi	mijë Lek	-	14 499 150
Fitimi para interesave, tatimit, amortizimit dhe zhvlerësimit (EBITDA)	mijë Lek	9 431 833	24 095 295
Zëra financiarë neto	mijë Lek	(997 835)	(712 602)
Pasqyra e pozicionit financiar			
Prona, makineri dhe pajisje dhe aktivet jo-materiale	mijë Lek	75 232 509	76 949 412
Aktivët totale	mijë Lek	91 296 358	93 827 303
Kapitali	mijë Lek	90 637 351	84 593 283
Flukset monetare			
Flukset monetare të përdorura në aktivitete investuese	mijë Lek	5 877	124 016
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	mijë Lek	11 232 082	13 512 413

Matësit Alternativë të Ecurisë

Siç përcaktohet në udhëzuesit e ESMA mbi matësit alternativ të ecurisë (MAE), një MAE nënkupton një matës financiar historik ose të ardhshëm të ecurisë financiare, pozicionit financiar, ose flukseve të parasë, ndryshe nga matësit financiarë të përcaktuar ose specifikuar në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

DHP përdor MAE-të e mëposhtme:

Fitimi para tatimit, amortizimit dhe zhvlerësimit (EIBTDA) përcaktohet si fitimi operativ para amortizimit dhe zhvlerësimit. MAE përdoret për të matur ecurinë e aktiviteve të shfrytëzimit. EBITDA nuk duhet të konsiderohet si një alternativë ndaj fitimit operativ dhe fitimit para tatimit si një tregues i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me parimet gjerësisht të pranura të kontabilitetit. EBITDA nuk është as një alternativë ndaj flukseve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit në përputhje me parimet gjerësisht të pranura të kontabilitetit.

Fitimi / humbja operacionale (EBIT) është MAE që përdoret për të matur ecurinë nga aktivitetet operacionale.

Të ardhurat bruto përcaktohen si shuma bruto e të ardhurave të njohura në pasqyrat financiare vjetore.

Të ardhurat neto përcaktohen si e ardhura bruto pasi janë zbritur shpenzimet për blerjen e energjisë, blerjen e kapaciteteve, siç paraqitet në pasqyrat financiare vjetore.

Kthim i humbjes nga zhvlerësimi lidhet me pronat, makineritë dhe pajisjet.

Devoll Hydropower Sh.A.

Adresa:

Rruga Papa Gjon Pali II-të, ABA Business Center
Zyra Nr. 1206, Tiranë, Shqipëri

Nipt: K82418002C

Tel: +355 4 450 14 50

Email: info.albania@statkraft.com

Web: www.statkraft.al

